




safejournalists.net

**MAQEDONIA E
VERIUT**
**Treguesit e nivelit
të lirisë së medieve
dhe sigurisë së
gazetarëve në
vitin 2020**



**MAQEDONIA E
VERIUT
Treguesit e nivelit
të lirisë së medie
dhe sigurisë së
gazetarëve në
vitin 2020**

**Autorë
Milan Spirovski
Verçe Todorovska-Kostovska**

Titulli

MAQEDONIA E VERIUT Treguesit e nivelit të lirisë së medieve dhe sigurisë së gazetarëve në vitin 2020

Botues

Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë



ЗДРУЖЕНИЕ
НА НОВИНАРИТЕ
НА МАКЕДОНИЈА

Autorë

Milan Spirovski, Verçe Todorovska-Kostovska

Përkthyes

Kristina Naceva

Lektura

Ferikan Iljazi

Recensente

Marina Tuneva

Dizajni

comma | communications design

Ky publikim është përpiluar me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian. Pëmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë së Veriut dhe e autorëve, dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se i reflekton pikëpamjet e Bashkimit Evropian.



PASQYRË DHE PËRFSHIRJA E PROJEKTIT	4	B Pozita e gazetarëve nëpër redaksi	20
SHËNIM METODOLOGJIK	5	B1 Kufizimet ekonomike në punën gazetareske	20
Hyrje	7	B2 Pavarësia redaktuese në mediet private	21
A Mbrojtja juridike	9	B3 Pavarësia redaktuese në servis publik	22
A1 Garancitë juridike për lirinë e medieve dhe gazetarëve dhe zbatimimi i tyre në praktikë	9	B4 Pavarësia redaktuese në sektorin jofitimprurës	23
A2 Efekti i ligjeve për shpifje ndaj gazetarëve	13	B5 Liria e gazetarëve në procesin e prodhimit të lajmeve	24
A3 Mbrojtja e pluralizmit politik në media	14	B6 Pozita ekonomike e gazetarëve femra	24
A4 Liria e punës dhe bashkimi i gazetarëve	16	C Siguria e gazetarëve	26
A5 Mbrojtja e burimeve të informacioneve	17	C1 Statistika e sigurisë dhe mosndëshkimit	26
A6 E drejta për qasje në informata	17	C2 Sjellja e institucioneve shtetërore dhe e aktorëve politikë ndaj mbrojtjes së gazetarëve	28
		C3 Sjellja e sistemit gjyqësor civil dhe penal ndaj kërcënimeve dhe dhunës mbi gazetarët	30
		Konkluzione dhe rekomandime	34

Pasqyrë dhe përfshirja e projektit

Për të pestin vit radhazi, shoqatat e gazetarëve nga Ballkani Perëndimor (Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Kosova dhe Serbia), me mbështetjen e Komisionit Evropian,¹ po monitorojnë zhvillimin e lirisë së mediejeve dhe sigurinë e gazetarëve në vendet e tyre. Në vitin 2020, edhe dy vende të tjera u angazhuan për vlerësime të tilla – Shqipëria dhe Kroacia. Metodologjia e hulumtimit, e zhvilluar në vitin 2016,² ishte harmonizuar gjatë viteve për t'u standardizuar grumbullimi dhe analizimi i të dhënave dhe për t'u përshtatur fokusi i hulumtimit në ndryshimet në mjedisin tradicional dhe online të mediejeve në Ballkanin Perëndimor. Bazuar në këtë mjet të standardizuar hulumtues, shoqatat e gazetarëve i vlerësuan zhvillimet e fundit në vendet e tyre dhe u angazhuan në aktivitete të ndryshme të përfaqësimit për të përmirësuar mjedisin politik, legjislativ dhe institucional në të cilin punojnë gazetarët dhe mediet.

-
- ¹ Në dhjetor të vitit 2019, Komisioni Evropian e miratoi projektin trevjeçar [Safejournalists.net](https://www.safejournalists.net), i cili synon të forcojë shoqatat kombëtare të gazetarëve në Ballkanin Perëndimor, në mënyrë që ato të bëhen aktorë të pavarur e të suksesshëm dhe të përgjegjshëm në avokimin për zbatimin e standardeve të BE-së në fushën e lirisë së mediejeve, me qëllimin afatgjatë për të avancuar të drejtën e qytetarëve në përzgjedhjen në informim. Ky veprim paraqet ndërlidhje e projektit të mëparshëm (Platforma Rajonale për Ballkanin Perëndimor për Avokatinë për Lirinë e Mediejeve dhe Sigurinë e Gazetarëve), bazuar në njohuritë dhe përvojën e ndërtuar në periudhën 2016-2018. Veprimi është mbështetur nga Programi për organizatat e shoqëritë civile dhe mediet 2018-2019, Mbështetje për rjetet tematike rajonale të organizatave të shoqërisë civile, mbështetje për rjetet rajonale për të drejtat e grave dhe barazinë gjinore dhe mbështetje për projekte me vëllim të vogël që promovojnë bashkëpunimin midis komuniteteve dhe qytetarëve nga Serbia dhe Kosova.
 - ² Botimi i pestë i adaptuar i metodologjisë kërkimore për këtë projekt hulumtues për avokim u zhvillua nga Snezhana Terpevska dhe Igor Micevski, hulumtues nga Instituti për Hulumtimin e Zhvillimit Shoqëror RESIS nga Maqedonia e Veriut (www.resis.mk).

Shënim metodologjik

Metodologjia e hulumtimit përbëhet nga tre grupe indikatorësh të zhvilluar, e që bazohet në një analizë sistematike të udhëzimeve të ndryshme të prodhuara nga organizata relevante ndërkombëtare.³

Gjatë viteve të mëparshme, treguesit e zhvilluar fillimisht u testuan dhe u rafinuan për të mbuluar kontekstin karakteristik socio-politik në këtë rajon dhe për të pasqyruar nevojat specifike dhe interesat e gazetarëve në shtatë vendet. Një numër i metodave të ndryshme të hulumtimit u aplikuan për të mbledhur dhe analizuar të dhëna në mënyrë që t'u përgjigjen pyetjeve indikative në lidhje me secilin tregues specifik:

- Rishikim i studimeve, analizave, raporteve nga hulumtimet, dokumenteve të politikave, strategjive dhe dokumenteve të tjera;
- Analizë cilësore e dokumenteve juridike;
- Kërkim dhe analizë të informacioneve të publikuara në ueb faqet e institucioneve publike dhe organizatave dhe organeve të tjera;
- Kërkim dhe analizë të kumtesave për opinion, publikimeve dhe informacioneve të tjera të përpiluara nga organizatat profesionale;
- Të dhëna sekondare të grumbulluara nga shoqatat e gazetarëve;
- Intervista të thelluara me ekspertë, gazetarë, politik-bërës etj.;
- Grupe fokusi me gazetarë; dhe
- Anketa me gazetarë (në disa nga vendet).

Në nivel kombëtar, shoqatat e gazetarëve nominuan hulumtues kombëtarë për të kryer grumbullimin e të dhënave dhe për të shkruar raporte narrative, të cilat më pas u shqyrtuan nga ekspertët kombëtarë dhe hulumtues kryesorë. Për të shqyrtuar raportin, në Maqedoninë e Veriut Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë së Veriut i nominoi Milan Spirovskin dhe Verçe Todorovska-Kostovska-n si hulumtues kombëtarë, ndërsa Marina Tuneva-n si eksperte e medieve.

Tre grupet e indikatorëve që u shfrytëzuan gjatë vlerësimit të nivelit të lirisë së medieve dhe sigurisë së gazetarëve në Ballkanin Perëndimor janë prezantuar në tabelën më poshtë.

Tabela 1: Treguesit e shkallës së lirisë së medieve dhe sigurisë së gazetarëve

A. Mbrojtja juridike	B. Pozita e gazetarëve në redaksi	C. Siguria e gazetarëve
A.1 Garancitë juridike për lirinë e medieve dhe zbatimin e tyre në praktikë	B.1 Kufizimet ekonomike të lirisë së medieve	C.1 Statistika për sigurinë dhe mosndëshkimin
A.2 Efekti i ligjeve për shpifje ndaj gazetarëve	B.2 Pavarësia redaktuese në mediet private	C.2 Sjellja e institucioneve shtetërore dhe politikanëve ndaj mbrojtjes së gazetarëve
A.3 Mbrojtja e pluralizmit politik në medie	B.3 Pavarësia redaktuese në servis publik	C.3 Sjellja e sistemit të drejtësisë penale dhe civile ndaj kërcënimeve dhe dhunës ndaj gazetarëve
A.4 Liria e punës dhe unanimiteti i gazetarëve	B.4 Pavarësia redaktuese në sektorin jofitimprurës	
A.5 Mbrojtja ligjore e burimeve gazetareske	B.5 Liria e gazetarëve në procesin e prodhimit të lajmeve	
A.6 Mbrojtja e së drejtës për qasje në informacione	B.6 Pozita ekonomike e gazetarëve	

³ Gjatë zhvillimit të qasjes specifike kërkimore për vendet e Ballkanit Perëndimor u morën parasysh këto dokumente: Këshilli i Evropës: Treguesit për mediet në demokraci; UNESCO: Treguesit për Zhvillimin e Medieve (MDI) dhe Treguesit e Sigurisë së Gazetarëve: Niveli kombëtar; USAID – IREX: Indeksi i Qëndrueshmërisë së Medieve; Freedom House: Anketa e Lirisë së Shtypit; Servisi Botëror i BBC: Iniciativa për Zhvillimin e Medieve Afrikane; Komiteti për Mbrojtjen e Gazetarëve: Dhuna ndaj Gazetarëve; Reporterët pa Kufij: Indeksi Botëror i Lirisë së Shtypit.

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut është akti më i lartë juridik që e përcakton shtetin si demokraci parlamentare me pushtet legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. Liria, barazia, sundimi i ligjit dhe respektimi i të drejtave të njeriut për të gjithë qytetarët janë vlerat më të larta në rendin kushtetues të vendit. Si rregull, pas zgjedhjeve parlamentare, qeverinë e formojnë partitë politike nga blloku maqedonas dhe shqiptar që kanë fituar më shumë vota në zgjedhje. Regjistrimi i fundit i popullsisë është kryer në vitin 2002, kur popullsia e përgjithshme e vendit ishte 2,022,547 banorë, me përkatësi të ndryshme etnike: maqedonas 65,17%, shqiptarë 25,17%, turq 3,85%, romë 2,66%, serbë 1,78% dhe një përqindje më e vogël e pjesëtarëve të bashkësive të tjera etnike (boshnjakë, vllah, bullgarë, malazezë etj.). Pandemia e shkaktuar nga Covid-19 paraqet një tronditje globale që nuk e kurseu as Ballkanin Perëndimor. Dëmi përfundimtar, për sa i përket humbjes së jetës së njerëzve dhe ekonomisë, është ende vështirë për t'u vlerësuar, por vlerësimet e hershme parashikojnë një rënie prej 4 deri në 6 përqind të produktit të brendshëm bruto në rajon (PBB). Mijëra qytetarë janë në rrezik të humbin punën e tyre, kurse masat e përkohshme qeveritare të mbështetjes (përfitimet e papunësisë, shtyrjet/anulimi i kontributeve tatimore dhe kontributeve për sigurim social etj.) kanë ndikim të rëndësishëm fiskal.

Situata politike në vitin 2020 ishte shumë e tensionuar, veçanërisht për shkak të skandaleve të korrupsionit që përfshinin bartës të funksioneve të larta publike dhe zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të mbajtura në korrik, pas zbutjes së përkohshme të situatës lidhur me pandeminë Covid-19. Pas zgjedhjeve, u formua Qeveria e udhëhequr nga Lidhja Social Demokrate e Maqedonisë (LSDM), në koalicion me Bashkimin Demokratik për Integritet (BDI) dhe subjekte të tjera më të vogla politike. Tensioni midis partive politike vazhdoi edhe pas zgjedhjeve dhe u pasqyrua qartë në polarizimin poli-

tik të shumë medie. Zbatimi i reformave sistemore në sektorin e medie, me gjithë përbërjen parlamentare të sapoformuar, ishte ende i bllokuar në Parlamentin e RMV-së. Vitin e shënon një numër në rritje i kërcënimeve dhe sulmeve online ndaj gazetarëve dhe jo-efektiviteti i institucioneve në ndëshkimin e sulmuesve. SHGM-ja regjistroi 14 sulme dhe kërcënime, prej të cilave më shumë se gjysma e këtyre rasteve ishin ndaj gazetarëve. Vetëm një nga këto raste që është hapur në gjykatat e Shkupit, është zgjidhur.

Për shkak të krizës ekonomike të shkaktuar nga pandemia, tregu mediatik dhe standardi social i gazetarëve dhe punonjësve mediatik u përkeqësuan akoma më shumë. Paga mesatare e gazetarëve është akoma më e ulët se mesatarja e vendit dhe pagat e gazetarëve nga qytetet më të vogla janë veçanërisht të ulëta. Megjithëse viti 2020 ishte veçanërisht i vështirë për mediet, për shkak të rënies së të ardhurave nga reklamat, Qeveria dhe rregullatori i medie, në një farë mase, i kanë zbutur efektet negative të krizës ekonomike përmes formave të ndryshme të subvencioneve të drejtpërdrejta dhe indirekte. Një burim shtesë i të ardhurave ishin mjetet e reklamimit politik gjatë fushatës zgjedhore, por ekziston një shqetësim i përgjithshëm se kjo minon pavarësinë e politikës redaktuese të me-

dieve. Gazetarët dhe punonjësit mediatik mbeten ekonomikisht të pasigurt dhe pothuajse nuk ka marrëveshje kolektive me të cilat mbrohen drejtat e tyre të punës. Mungojnë informacionet zyrtare në lidhje me numrin e përgjithshëm të gazetarëve të punësuar, por, sipas vlerësimeve të SHGM-së, ka rreth 1,000 gazetarë që punojnë në vend në të gjitha llojet e medie, duke përfshirë edhe servisin publik.

Mediet e kanë të vështirë të mbijetojnë në tregun e vogël, por të mbushur mediatik. Analistët e Rregullatorit thonë se buxhetet po zvogëlohen, kurse dhjetëra media gjatë vitit të kaluar kanë pushuar së funksionuari. Në fillim të vitit 2020, në sektorin audio-vizual punonin 121 medie, nga të cilët 49 TV dhe 72 radio stacione. Gjithsej 11 medie emetojnë Tv programe në nivel kombëtar (5 tokësorë, 4 kabllorë dhe 2 TV satelitorë), 18 në nivel rajonal dhe 19 në nivel lokal. Nga radiostacionet, vetëm 4 transmetojnë në nivel kombëtar, 17 në nivel rajonal dhe mbi 50 në nivel lokal. Në vitin 2019, u mbyll botimi i gazetës ditore Nezavisen kështu që mbetën gjithsej 5 gazeta ditore në treg (3 në gjuhën maqedonase dhe 2 në gjuhën shqipe), kurse në sferën online veprojnë mbi 170 media, prej tyre rreth 140 janë anëtare të Regjistrimit të Mediave Profesionale Online.

A1 Garancitë juridike për lirinë e medie dhe gazetarëve dhe zbatimi i tyre në praktikë

A është e garantuar e drejta për lirinë e shprehjes dhe informimit? A përfshin kjo edhe qasje në internet? A zbatohen në praktikë këto garanci juridike?

Përveç në Kushtetutë, garancitë themelore për lirinë e shprehjes dhe pavarësia e medie janë inkorporuar në ligjet mediatike dhe në disa ligje të tjera. Të gjitha këto ligje, gjithashtu, mbulojnë të drejtën e qasjes në internet, respektivisht nuk ekziston ndonjë legjislacion i veçantë që rregullon vetëm internetin. Vlerësimi i zbatimit të këtyre garancive nuk është pozitiv, kryesisht për faktin që, krahasuar me vitin 2019, numri i kërcënimeve dhe sulmeve të regjistruara ndaj gazetarëve dhe medie ishte katër herë më i lartë, dhe më shumë se gjysma e sulmeve ishin ndaj gazetarëve.⁴ Në vitin 2020, kriza Covid-19 e përkeqësoi edhe më tej situatën financiare të medie për shkak të rënies së të ardhurave nga reklamata komerciale. Qeveria e RMV-së prezantoi një sërë masash për të ndihmuar sektorin mediatik, por efektet e tyre nuk mund të shiheshin sepse kriza e pandemisë vazhdoi deri në fund të vitit. Sidoqoftë, në vitin 2020 vendi shënoi rri-

⁴ Dragan Sekulovski dhe Deniz Sulejman, "Maqedonia e Veriut – Tregues për nivelin e lirisë së medie dhe për sigurinë e gazetarëve", Shkup: SHGM, 2019. Qasur më: 18.12.2020. <https://safejournalists.net/wp-content/uploads/2020/12/MK-MK-2019.pdf>

tje në shkallën e Reporterëve pa Kufij⁵. Nga gjithsej 180 vende, RMV-ja u rendit në vendin e 92-të, që është tre vende më lartë se në 2019-ën.

A u përpilua legjislacioni për media në një proces transparent dhe gjithëpërfshirës në konsultim me organizatat relevante profesionale?

Qeveria e RMV-së, gjatë gjendjes së jashtëzakonshme të shkaktuar nga pandemia Covid-19, në fillim të prillit të vitit 2020, miratoi disa ndryshime në Ligjin për Shërbimet Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në mënyrë jo mjaftueshëm transparente dhe gjithëpërfshirëse. Kjo u iniciua pas konfliktit midis televizioneve kablore dhe kombëtare dhe pasi Kuvendi i RMV-së i miratoi ndryshimet në Ligj disa minuta para shpërbërjes së tij në shkurt të vitit 2020. Pas mbajtjes së zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, më 15 korrik të vitit 2020, përbërja e re parlamentare nuk i zbatoi aktivitetet e paralajmëruara për zgjedhjen dhe emërimin e organeve drejtuese vendimmarrëse në RTM dhe në Agjencinë e Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (ASHMAA). Në fund të vitit 2020, SHGM-ja ishte e përfshirë në grupe pune për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për përgjegjësinë civile për shpifje dhe fyerje, dhe u konsultua edhe për ndryshimet dhe plotësimet në Kodin Penal në lidhje me mbrojtjen më të madhe të gazetarëve dhe punonjësve mediatik. Sidoqoftë, vërejtje thelbësore e SHGM-së është se procesi i ndryshimeve të këtyre ligjeve është i ngadaltë dhe pa kornizë të përcaktuar kohore për miratim dhe zbatim.⁶

A janë përpjekur ndonjëherë autoritetet të vendosin regjistrim ose kushte të tjera më të rrepta për themelimin e medieve të shtypura ose medieve të internetit? A përfshijnë kërkesat më shumë sesa regjistrim të zakonshëm të biznesit dhe taksave?

Për themelimin e një mediumi të shtypur ose online nuk ka kërkesa të veçanta, përveç procedurës së zakonshme të regjistrimit të mediumit si subjekt afarist tek autoritetet kompetente. As mediet e shtypura dhe as ato online nuk i nënshtrohen legjislacionit për media, respektivisht në komunitetin e medieve mbizotëron pikëpamja se ato duhet t'i nënshtrohen vetë-rregullimit. Me qëllim të fuqizimit të vetë-rregullimit në medie, si dhe me qëllim

të ngritjes së nivelit të profesionalizmit dhe standardeve në gazetarinë online, SHGM-ja dhe Këshilli për Etikë në Media në Maqedoni (KEMM) vazhduan me promovimin e Regjistrimit të Mediave Online,⁷ i cila u themelua në dhjetor të vitit 2019 e që u mirëprit nga Federata Evropiane e Gazetarëve, Zyra e OSBE-së në Vjenë, Ambasada e SHBA-ve në Shkup dhe u nënvizua në Raportin e Komisionit Evropian⁸ si një praktikë e mirë. Edhe gjatë vitit 2020 vazhduan përpjekjet për avancimin e vetë-rregullimit të medieve online në vend. Numri i anëtarëve të sapo regjistruar në Regjistrin e Medieve Profesionale Online në vitin 2019 ishte 72, kurs në fund të vitit 2020 ky numër u rrit në gjithsej 138 anëtarë.

A janë përpjekur ndonjëherë autoritetet të kufizojnë të drejtën e qasjes në internet ose të kërkojnë bllokimin ose filtrimin e përmbajtjeve të internetit?

Ashtu sikurse në vitin 2019 edhe në vitin 2020 nuk u regjistrua asnjë përpjekje nga Qeveria ose ndonjë organ tjetër shtetëror për të bllokuar ose filtruar internet-përmbajtjet. Vlerësimi është se e drejta për lirinë e shprehjes në hapësirën e Internetit përdoret lirish nga qytetarët, nga organizatat mediatike dhe të tjerë.

A e kryen organi rregullator misionin dhe funksionet e tij në një mënyrë të pavarur dhe jo-diskriminuese? A zbatohen në mënyrë korrekte dhe neutrale procesi i licencimit dhe rregullativat e tjera të transmetimit?

Në vitin e kaluar, Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë së Veriut nuk vërejti ndonjë kritikë për funksionimin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (ASHMAA), që ishin të zakonshme në vitet e fundit. Puna e ASHMAA-së mund të vlerësohet si e pavarur dhe objektive, pa qëndrim diskriminues ndaj medieve të caktuara audio-vizuale. Sidoqoftë, në Raportin e OSBE dhe ODIHR⁹ mbi zgjedhjet parlamentare të 15 korrikut të vitit 2020 në RMV, vërehet se “përmirësimet e konsiderueshme në liritë e medieve në vitet e fundit nuk janë përforcuar me reformat sistematike të sektorin mediatik, siç është sigurimi i neutralitetit politik në servisin publik dhe rregullatorin e medieve”.

5 Reporterët pa Kufij, “Maqedonia e Veriut: Raport i Reporterëve pa Kufij për vitin 2020”, Paris: 2021. Qasur më: 15.04.2021. <https://rsf.org/en/north-macedonia>

6 Megjithëse ndryshimet në Ligjin për përgjegjësinë civile për shpifje dhe fyerje ishin parashikuar që në “Planin 18” të vitit 2018, Grupi i punës i Ministrisë së Drejtësisë, që u themelua në qershor 2019, filloi të punojë madje në fund të vitit 2020.

7 Regjistrimi i mediave online – Promedia, www.promedia.mk

8 Komisioni Evropian, “Raporti i Komisionit Evropian për vitin 2020”, Bruksel: 2020. Qasur më: 15.11.2020. <https://www.sep.gov.mk/post/?id=5657#YAGhuthKJlU>

9 OSBE/ODIHR, “Republika e Maqedonisë së Veriut: Zgjedhjet e parakohshme parlamentare 15 korrik 2020 (Raporti përfundimtar)”, Varshavë: 2020. Qasur më: 25.10.2020. <https://www.osce.org/files/f/documents/0/a/471672.pdf>

A ekzistojnë dispozita ligjore në lidhje me reklamën shtetërore në media dhe a keqpërdoren ato për ndikim politik në politikën e tyre redaktuese? A bëhet shpërndarja e fondeve shtetërore në mënyrë transparente, të drejtë dhe jo-diskriminuese? A publikojnë rregullisht institucionet shtetërore të dhëna për shumën që janë ndarë për medie të ndryshme?

Çështja e reklamave shtetërore nuk është e rregulluar me ligjet e medieve, kurse që në vitin 2016 Qeveria e LSDM-së vendosi për një moratorium të plotë mbi reklamën shtetërore, me kërkesë të SHGM-së dhe sektorit jo-qeveritar. Në vitet e mëparshme, ky vendim ishte respektuar, por në nivelin lokal, komunat dhe ndërmarrjet publike, megjithatë, kanë ndarë fonde nga buxhetet e tyre për mediet private lokale që, në thelb, minonin pozicionin e tyre të pavarur. Në vitin 2020, Qeveria njoftoi për mundësinë e heqjes së ndalesës për reklamim në medie private, me fonde publike, gjë që u kritikua ashpër nga SHGM-ja dhe organizata të tjera gazetareske dhe mediatike, pasi kjo mund të rrezikojë pavarësinë redaktuese të medieve, të minojnë më tej tashmë tregun e ndjeshëm mediatik dhe të forcojë klientelizmin.

Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM), Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Punonjësve Mediatik (SPGPM), Instituti Maqedonas i Medieve (IMM) dhe Këshilli për Etikë në Media (KEMM) e theksojnë fuqimisht kundërshtimin e tyre ndaj ndryshimeve të mundshme të nenit 102 të Ligjit për shërbimet mediatike audio dhe audio-vizuale, me të cilat do të lejohej reklamimi i institucioneve publike në media. SHGM-ja, SPGPM-ja, IMM dhe KEMM konsiderojnë se është e papranueshme që situata në industrinë e mediatike të kthehet në nivelin e katër viteve më parë, kur me fonde shtetërore, në mënyrë jo transparente, u paguhehin medieve shuma astronomike pa asnjë kriter. Kjo praktikë, të cilën ne e kundërshtuam, u vlerësua si një shembull i keq i rryshfetit shtetëror të medieve dhe kontribuoi në përkeqësimin e situatës në media dhe në rritjen e paragjykitimit në raportimin e tyre. Ky reagim¹⁰ i katër organizatave pasoi pas njoftimit të kryeministrit Zoran Zaev se "së shpejti do të jepet një propozim nga MSHIA (Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës) për shfuqizimin e nenit 102 të Ligjit për Shërbimet Mediatike Audio dhe Audiovizuale, respektivisht ndryshimin e të njëjtit në mënyrë që të ndihmojmë mediet përmes arritjes së marrëveshjeve me ndërmarrjet publike, komunat, etj., në drejtim të transparencës së tyre dhe zbatimit të vendimeve të tyre, siç janë seancat e Këshillave Drejtues, të Këshillave etj".

¹⁰ SHGM, SPGPM, KEMM dhe IMM, "Nuk duhet lejuar ligj për reklamim shtetëror në media", Shkup: 2020. Qasur më: 17.12.2020. <https://bit.ly/3bnROFI>

Nëse një propozim i tillë pranohet, ai nuk do të çojë në ndonjë përmirësim të situatës në media dhe në lirinë e informimit por, përkundrazi, ai do të prishë më tej tregun mediatik edhe ashtu të ndjeshëm dhe do të forcojë klientelizmin. Në të njëjtën kohë, qëndrim i SHGM-së është se është e nevojshme të ndihmohen mediet, veçanërisht kur kriza financiare po rritet, por ajo duhet të jetë në një mënyrë transparente, duke krijuar një fond për mediet me kritere të përcaktuara qartë, ku çdo medium mund të aplikojë për projekte me interes publik.¹¹

A ekziston ndonjë lloj i subvencioneve mediatike ose fondeve për prodhimin e përmbajtjeve mediatike me interes publik dhe si zbatohen ato në praktikë?

Në kulmin e pandemisë së shkaktuar nga Covid-19, në seancën e 25-të të rregullt të Qeverisë u miratua një Program për mbështetje për botimin dhe shpërndarjen e medieve të shtypura për vitin 2020,¹² në vlerë prej 30 milionë denarësh, që është një shumë dukshëm më e ulët se në vitet e kaluara.¹³ Programi¹⁴ zbatohet për të tretin vit radhazi, me qëllim mbështetjen e medieve të shtypura me karakter të përgjithshëm dhe informativ. Për ndarjen e mjeteve, për të cilat nuk ka asnjë mekanizëm për të kontrolluar se si ato shfrytëzohen, vendos Komisioni, i cili, përveç përfaqësuesve të institucioneve kompetente, si anëtarë ka edhe nga një përfaqësues të Asociacionit për Mbrojtjen e Medieve të Shtypura Nationale dhe Shoqatës së Gazetarëve. Komisioni mori vendim bazuar në kritere të përcaktuara qartë, dhe shumica e mbështetjes së aprovuar është përcaktuar në bazë të faturave të paraqitura për vitin kalendarik 2019.

Gjatë pandemisë, Qeveria vendosi¹⁵ të sigurojë edhe subvencione të drejtpërdrejta për të gjitha mediet, për të paguar kontributet e sigurimeve shoqërore për pagat e gazetarëve dhe punonjësve të tjerë të mediatik. Përveç kësaj, Qeveria miratoi edhe disa dekrete me të cilat medieve u ndanë subvencione indirekte: televizionet, programet e të cilave transmetohen përmes multipleksit digjital u liruan nga pagesa e shpenzimeve të transmetimit për tërë vitin 2020; Radiostacionet u liruan nga pagesa e kompensimit për frekuencat e radi-

¹¹ SHGM, „Fushatat publike në media duhet të jenë falas”, Shkup: 2021. Qasur më: 27.02.2021. <https://bit.ly/3w8Ayfn>

¹² Qeveria e RMV, "Kumtesë nga seanca e 25-të e Qeverisë", Shkup: 2020. Qasur më: 15.12.2020. <https://vlada.mk/node/23392>

¹³ Qeveria e RMV, "Programi për mbështetje për shtypjen dhe distribuimin e mediave të shtypura për vitin 2018", Shkup: 2018. Qasur më: 24.12.2020. https://vlada.mk/sites/default/files/ima/prezentacija_-_programa_za_pechateni_mediumi.pdf

¹⁴ Qeveria e RMV, "Programi për mbështetje për shtypjen dhe distribuimin e mediave të shtypura për vitin 2020", Shkup: 2020. Qasur më: 30.12.2020. <https://vlada.mk/node/23762>

¹⁵ Vendim i Qeverisë së RMV, 02.04.2020. <https://vlada.mk/node/20837>

os dhe për transmetimin e programeve përmes rrjetit të ndërmarrjes publike Radiodifuzioni i Maqedonisë. Por, procesi i vendimmarrjes për këto subvencione ka qenë mjaft i diskutueshëm. Televizionet kombëtare negociuan drejtpërdrejt me Qeverinë (prapa dyerve të mbyllura) duke kërkuar që vetëm ata të merrnin subvencione dhe, më pas, pas reagimit të medieve dhe radios-tacioneve rajonale dhe lokale, vendimi u ndryshua dhe u aplikua për të gjithë radiodifuzerët. Organi rregullator gjithashtu vendosi që t'i lirojë të gjitha radiostacionet dhe televizionet private nga pagesa e kompensimit për licencë për vitin 2019 dhe për vitin 2020, kurse servisit publik i ndau ndihmë financiare në shumë prej 30,000,000.00 denarësh.¹⁶

Shoqata e Gazetarëve (SHGM) dhe Misioni i OSBE-së në Shkup, në prill të vitit 2020, siguruan paketa me mjete mbrojtëse për mediet në Maqedoninë e Veriut. Secila prej paketave që u shpërndanë në media përmbanin maska mbrojtëse, doreza, syze, mjete dezinfektimi dhe të tjera. Mlladen Čadikovski, kryetar i SHGM-së, tha se informimi, veçanërisht në kushte pandemie, është i rëndësishëm dhe se gazetarët duhet të mbrohen në mënyrë që lajmet e vërteta të arrijnë tek qytetarët.¹⁷

Cilat janë mekanizmat për financimin e medieve në gjuhët e komuniteteve?

Përveç radio dhe TV programeve në gjuhët e bashkësi-ve etnike, në kuadër të servisit publik radiodifuziv, nuk ekzistojnë mekanizma të tjerë për financimin e medieve në gjuhët e bashkësi-ve të ndryshme etnike. Mediet që publikojnë përmbajtje në gjuhët e komuniteteve jo-shumicë në RMV nuk janë tërheqëse për reklamuesit, kështu që ata po përballen me vështirësi financiare prej vitesh për të mbijetuar në treg. Ka mungesë të një politike adekuate mediatike për të zgjidhur këtë problem, e cila pasqyrohet në tablonë e përgjithshme pluraliste në media në RMV.

A janë të garantuara dhe të mbrojtura në mënyrë efektive sovraniteti dhe pavarësia e servisit publik radiodifuziv? A siguron korniza e financimit pavarësinë dhe funksionimin e tij të qëndrueshëm? A përfaqësojnë organet e mbikëqyrjes shoqërinë në tërësi?

Reforma e servisit publik ishte një nga kërkesat kryesore të sektorit joqeveritar për zbatimin e reformave gjithëpërfshirëse në sferën mediatike. Kjo reformë u kushtëzua pjesërisht nga rritja e buxhetit të këtij mediumi, si dhe nga zgjedhja e anëtarëve të rinj të Këshillit Programor të Radiotelevizionit të Maqedonisë (RTM). Financimi i RTM-së u ndryshua plotësisht në vitin 2018, kur nga taksa radiodifuzive (tarifë publike) kaloi në përqindje fikse nga Buxheti i RMV-së, në mënyrë që të sigurohej financim afatgjatë dhe i qëndrueshëm. Sidoqoftë, RTM-ja ende po përballlet me probleme financiare për shkak të borxheve nga vitet e mëparshme dhe për shkak të faktit se Qeveria nuk i paguan RTM-së në tërësi fondet sipas dinamikës së parashikuar në ligj. Sipas përlllogaritjeve të SHGM-së, RTM-ja në vitin 2021, me uljen e buxhetit, do të ketë të ardhurat më të ulëta në tre vitet e fundit.

Nga ana tjetër, me ndryshimet e Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, Radiotelevizioni i Maqedonisë mori detyrime shumë më të mëdha programore. Është e detyruar të hapë edhe një kanal tjetër 24-orësh në gjuhën shqipe, me çka numri i përgjithshëm i kanaleve televizive do të rritet në 5 dhe do të ketë pasojë financiare shtesë në punën e tij. Në periudhën e pandemisë Covid-19, më e rëndësishme është hapja e kanalit për fëmijë, në të cilin ofrohet më shumë program arsimor dhe edukativ për nxënësit.

Reforma e servisit publik radiodifuziv është në një fazë të hershme dhe duhet t'i jepet prioritet në Kuvendin e RMV. Sipas Ligjit për Shërbimet Mediatike Audio dhe Audiovizuale, shuma e financimit publik të servisit publik radiodifuziv përcaktohet si përqindje e buxhetit të shtetit, me rritje graduale me kalimin e kohës (deri në 0.8% në vitin 2019; deri në 0.9% në vitin 2020); 1% nga viti 2021). Për shkak të drejtave diskrete të autoriteteve, të parashikuara me ligj, transferimi i fondeve vazhdoi të kryhej në një përqindje më të ulët (rreth 0.6%), pavarësisht nga fakti se kanalet shtesë u hapën në fillim të prillit të vitit 2020. Prandaj, pavarësia financiare dhe qëndrueshmëria e radiodifuzerit publik mbe-ten në pikëpyetje. Është po aq e rëndësishme të gjenden zgjidhje për borxhet e vjetra të servisit të radiodifuzerit publik ndaj institucioneve shtetërore. Nevojiten përpjekje shtesë për të përmirësuar cilësinë e raportimit të tij dhe për të modernizuar procedurat e tij të funksionimit dhe pajisjet teknike. Programet e dedikuara për fëmijë u transmetuan në të dy kanalet kombëta-

16 ASHMAA, "Vendim për ndarjen e ndihmës financiare – donacion për ballafaqim me pasojat nga pandemia me Covid-19"; Shkup: 2020. Qasur më: 15.09.2020. <https://avmu.mk/wp-content/uploads/2020/03/Odluka-za-dodeluvanje-finansiska-pomos-donacija-koronavirus.pdf>

17 SHGM, "SHGM dhe OSBE: Janë siguruar mjete mbrojtëse për gazetarët dhe punonjësit mediatik", Shkup: 2020. Qasur më: 20.09.2020. <https://znm.org.mk/znm-i-obse-obezbedeni-zashtitnite-sred/>

re, si mbështetje dhe plotësim të procesit arsimor që u ndërpre për shkak të pandemisë.¹⁸

Organi që, në fakt, duhet t'i konceptojë dhe zbatojë reformat në RTM është Këshilli Programor, por zgjedhja e anëtarëve të rinj, si një nga kërkesat kryesore për ngritjen e nivelit të pavarësisë së RTM, nuk ndodhi as në vitin 2020. Në vend të kësaj, Kuvendi mori vendim të zgjasë mandatin e anëtarëve ekzistues, pa kryer procedurë të re për zgjedhje. Ky organ përgatiti një draft-strategji për zhvillimin pesëvjeçar të RTM-së dhe zhvilloi konsultime, në të cilat SHGM-ja dhe organizatat tjera relevante dhe ekspertët dhanë propozimet dhe vërejtjet e tyre. Në konsultime u theksua se është pozitive që Këshilli Programor vendosi të miratojë një strategji zhvillimore, por që nevojitet një kompletim serioz i këtij dokumenti.

A2 Efekti i ligjeve për shpifje ndaj gazetarëve

A janë shumë të rrepta dispozitat e ligjeve për shpifje dhe a i mbrojnë ato funksionarët e shtetit? Cilat janë mangësitë kryesore të këtyre ligjeve?

Veprat shpifje dhe fyerje u dekriminalizuan në vitin 2012, me miratimin e Ligjit për Përgjegjësinë Civile për Fyerje dhe Shpifje. Në vitin 2020, Ministria e Drejtësisë krijoi një grup pune për ndryshimin dhe plotësimin e këtij Ligji, në të cilin përfaqësues të SHGM-së gjithashtu morën pjesë aktive. U mbajtën disa takime, kurse në dhjetor të vitit 2020 u përpilua tekst i ri për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit, i cili pranoi pothuajse të gjitha propozimet e SHGM-së për të zvogëluar shumën e dëmit jo-material gjatë fajt të konstatuar të një gazetari dhe për të plotësuar pjesët për përjashtim nga përgjegjësia për shpifje dhe fyerje. Qëllimi i propozimeve të SHGM-së ishte që dispozitat e këtij ligji të bëhen më të favorshme për gazetarët, në drejtim të uljes së ndëshkimeve, në mënyrë që të mos ndikojnë negativisht në gazetarinë e lirë dhe kritike. Për më tepër, gjatë diskutimeve në grupin e punës, SHGM-ja e theksoi pikëpamjen se duhet pasur kujdes me dispozitat e këtij ligji që të mos rrezikohet e drejta e lirisë së shprehjes në internet, veçanërisht në lidhje me rrezikun e rregullimit të tepruar të përmbajtjeve të portaleve online.

Sa padi janë ngritur kundër gazetarëve nga funksionarët shtetërorë gjatë vitit të kaluar? A janë të motivuara politikisht aktgjykimet e gjykatave kundër gazetarëve? Cilat janë dënimet e shqiptuara?

Paditë për shpifje dhe fyerje ndaj gazetarëve dhe medieve kanë rënë në mënyrë dramatike, që kur u dekriminalizuan shpifjet dhe fyerjet. Kështu, në vitin 2016 kishte 40, kurse në vitin 2017 39 lëndë, që është një ndryshim i madh krahasuar me vitin 2012, kur u regjistruan 330 padi gjyqësore.¹⁹ Sipas të dhënave të marra nga Gjykata Themelore Civile në Shkup, numri i përgjithshëm i çështjeve aktive të padive gjyqësore për përgjegjësi civile për fyerje dhe shpifje në vitin 2020 ishte 147, nga të cilat në 33 raste pala është gazetar ose media. Kjo tregon se ka gjithnjë e më pak raste të shpifjes dhe fyerjes ndaj gazetarëve, respektivisht shpifja dhe fyerja përdoren gjithnjë e më pak si një instrument për të ushtruar presion mbi gazetarët dhe mediet.

A e njohin gjykatat mekanizmin vetërregullues (nëse ekziston)? A e pranojnë ata vlefshmërinë e një përgjigje, korrigjimi ose faljeje të botuar?

Sipas avokatëve të SHGM-së që përfaqësojnë gazetarët në çështjet gjyqësore për veprat shpifje dhe fyerje, gjykatësit zakonisht i marrin parasysh vendimet e Këshillit për Etikë në Medie (organi vetërregullues mediatik) gjatë zhvillimit të procedurës gjyqësore. Përveç kësaj, ekziston një praktikë në rritje që avokatët të përdorin vendimet e KEMM-it në procedurat gjyqësore si argument shtesë në favor të gazetarëve. Përveç kësaj, shpjegimet e aktgjyqimeve, në të cilat të paktën njëra nga palët është gazetar, shpesh citojnë raste nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, që paraqet progres krahasuar me të kaluarën.

Sipas përvijës sime personale praktike në përfaqësimin e gazetarëve në procedurat civile për të përcaktuar përgjegjësinë për fyerje dhe/ose shpifje dhe kompensim të dëmit jo-material, në aspekt të mbrojtjes së lirisë së shprehjes dhe zbatimit të praktikës të Gjykatës së Strasburgut për të Drejtat e Njeriut, praktika në vitet e fundit me gjykatat në RMV-së në përgjithësi është pozitive. Praktika e gjykatave në RMV, në vitet e fundit, është të shmanget kompensimi në të holla për dëmin jo-material të shkaktuar nga dhimbja shpirtërore nga fyerja dhe/ose shpifja, veçanërisht për gazetarët që janë paditur, që është një hap pozitiv për vetë gjyqtarët. Sidoqoftë, ne ende nuk kemi një pra-

¹⁸ Komisioni Evropian, "Raport i Komisionit Evropian për Maqedoninë e Veriut për vitin 2020", Bruksel: 2020. Qasur më: 15.11.2020. <https://www.sep.gov.mk/post/?id=5657#YAGhuthKjIU>

¹⁹ SHGM, "Analiza: Aktgjykimet për shpifje dhe fyerje të lëndëve gjyqësore me gazetarë", Shkup: 2018. Qasur më: 16.09.2020. <https://znm.org.mk/analiza-presudi-zakleveti-i-navredi-n/>

çtikë të harmonizuar në të gjitha Gjykatat rajonale të Apelit në RMV, në lidhje me ekspertizat e paraqitura psikiatrike nga vetë paditësit, përmes të cilave përcaktohet intensiteti dhe kohëzgjatja e dhimbjes emocionale të shkaktuar nga fyerja dhe/ose shpifja. Ivan Breshkovski, ekspert juridik dhe avokat.²⁰

Çfarë mendojnë gazetarët për Ligjin për shpifje? A janë të dekurajuar të hulumtojnë dhe shkruajnë në mënyrë kritike?

Gazetarët që ishin pjesë e fokus grupeve,²¹ të kryera për qëllimet e kësaj analize, vlerësojnë se paditë për shpifje dhe fyerje janë përdorur më shumë si një instrument për t'u bërë presion atyre në të kaluarën. Sidoqoftë, sot ende vërehet presion mbi gazetarët nga ana e të fuqishmëve financiarisht.

Për një rast presioni nga të fuqishmit financiarë dëshmoi gazetarja e cila mori pjesë në fokus grupet: - Ne ishim nën presion kur hulumtuam për testet për Covid-19 që i kryen Spitali "Sistina". Ne kishim një përgjigje për tekstin tonë, që nuk ishte aspak demant, por ishte një tekst shpifës, në të cilin na quanin përfutues dhe joprofesionistë dhe, për fat të keq, një pjesë e madhe e medieve e transmetuan atë. Në demantin e tyre ne kishim përgjigje për këtë, që u pasua me kërcënim të drejtpërdrejtë, madje ishte shkruar që do të ngritë padi penale për atë tekst. E dimë se si funksionojnë kolegët dhe mediet, se ka shumë reklama nga "Sistina" tek ata dhe e transmetuan këtë reagim, e nuk e transmetuan tekstin tonë, por reagimin e Kamçevit.

A3 Mbrojtja e pluralizmit politik në media

A është rregulluar pluralizmi politik në media në legjislacionin e medieve jashtë periudhave zgjedhore? Cilat janë përgjegjësitë e servisit publik dhe radiodifuzerëve privatë në lidhje me pluralizmin politik jashtë periudhave të zgjedhjeve?

Ligji për Shërbimet Mediatike Audio dhe Audiovizuale nuk e përmend në mënyrë të qartë "pluralizmin politik" si një detyrim të ofruesve të shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale kur nuk është koha e fu-

shatës zgjedhore. Megjithatë, parimet për kryerjen e veprimtarisë përmbajnë një dispozitë,²² e cila u referohet të gjithë radiodifuzerëve dhe të cilën rregullatori e përdor si bazë për monitorimin e raportimit të tyre në periudhën nga shpallja e zgjedhjeve deri në fillimin zyrtar të fushatës zgjedhore, kur zbatohen dispozitat e parashikuara në Kodin Zgjedhor. Detyrimet për RTM-në, në lidhje me këtë çështje, përveç në nenin mbi parimet për kryerjen e veprimtarisë, parashikohen gjithashtu në nenin 110.²³

A është Organi rregullator i detyruar të monitorojë dhe mbrojtë pluralizmin politik jashtë periudhave zgjedhore?

Megjithëse nuk është definuar qartë detyrimi i Rregullatorit për të monitoruar pluralizmin politik jashtë fushatës zgjedhore, megjithatë në kompetencat e përgjithshme të rregullatorit theksohet se ai "kujdeset për mbrojtjen dhe zhvillimin e pluralizmit të shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale", që e nënkupton edhe këtë aspekt të pluralizmit politik. Në vitet e fundit, Rregullatori ka kryer analiza të pluralizmit politik edhe jashtë periudhës zgjedhore dhe, gjithashtu, ka miratuar një Doracak të veçantë.²⁴

Një çështje shqetësuese nga aspekti i mbrojtjes së pluralizmit politik është reklamimi i paguar, i cili nuk është i ndaluar në mënyrë të qartë me ligj në periudhën jashtë zgjedhjeve. Ky vakum në legjislacion, në të kaluarën, ishte keqpërdorur në formën e të ashtuquajturës reklamim i arritjeve të partisë në pushtet, por me fonde nga Buxheti. Qëndrimi i SHGM-së është që reklamimi i paguar politik në mediet audiovizuale duhet të shfuqizohet në çdo kohë, sepse në atë mënyrë "blihen" pronarët e medieve, ndikohet negativisht në politikën redaktuese, por gjithashtu "zhvendoset" balanci i pikëpamjeve të kundërta në sferën publike. Kjo aq më tepër që partitë politike kanë mundësinë të "blejnë" hapësirën mediatike me fonde publike, duke pasur parasysh se ato tani kryesisht financohen nga Buxheti i RMV-së. Për të kapërcyer këtë praktikë, nevojiten ndërhyrje si në Ligjin për Shërbimet Mediatike Audio dhe Audiovizuale ashtu edhe në Kodin Zgjedhor, në

22 Neni 61 i Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale e rregullon parimin për "prezantim objektiv dhe të paanshëm të ngjarjeve me trajtim të barabartë të pikëpamjeve dhe mendimeve të ndryshme dhe mundësimin e formimit të lirë të mendimit të publikut për ngjarje dhe çështje të caktuara".

23 Në nenin 110, ndër të tjera, përcaktohet detyrimi i servisit publik: "të sigurojë informim të vazhdueshëm, të vërtetë, të plotë, të pa anshëm, të drejtë dhe në kohë duke krijuar dhe transmetuar programe me cilësi të lartë për të gjitha ngjarjet me rëndësi politike, ekonomike, sociale, shëndetësore, kulturore, arsimore, shkencore, fetare, ekologjike, sportive dhe të tjera ..."

24 AShMAA, "Doracak për vlerësimin e pluralizmit mediatik", Shkup: 2012. Qasur më: 10.09.2020. https://avmu.mk/wp-content/uploads/2017/05/Priracnik_1_Pluralizam_finalna.pdf

20 Intervistë me Ivan Breshkovski, ekspert juridik dhe avokat, realizuar më datën 10.12.2020.

21 Për nevojat e këtij hulumtimi u zbatuan dy fokus grupe me gjithsej 17 gazetarë, Fokus grupi i parë u realizua më dt. 24.12.2020 me gazetarë nga 7 media, kurse i dyti më dt. 29.12.2020, me gazetarë nga 6 media.

mënyrë që të ndalohet plotësisht reklamimi i paguar politik në mediet private në çdo kohë.

A kanë partitë politike dhe kandidatët qasje të drejtë dhe të barabartë në media jashtë periudhës së zgjedhjeve?

Si në vitin 2019, ashtu edhe në vitin 2020, as Rregullatori dhe as ndonjë organizatë tjetër nuk ka kryer një analizë të pluralizmit politik në lajme, kështu që është e vështirë të përgjigjesh saktësisht nëse partitë politike kanë qasje të drejtë në mediet audiovizuale jashtë zgjedhjeve. Por, vlerësimi i përgjithshëm i ekspertëve të medieeve, të intervistuar për qëllimet e kësaj analize, është se situata sot është përmirësuar ndjeshëm krahasuar me periudhën deri në vitin 2016, kur mediet audiovizuale më me ndikim raportin vazhdimisht nën ndikimin e partisë në pushtet. Sidoqoftë, megjithëse mediet radiodifuzive në tërësi raportojnë mbi pikëpamjet e ndryshme aktuale politike, është shqetësues fakti që në emisionet ditore-informative mbizotërojnë “grindjet” e partive kryesore.²⁵ Nga ana tjetër, mediet e shtypura dhe ato online kanë më shumë liri në zgjedhjen e një pozicioni politik ose ideologjik, kështu që është e prishme që disa subjekte politike të caktuara kenë qasje më të madhe atje.

Cilat janë detyrimet ligjore të medieeve gjatë proceseve zgjedhore? Cili organ i monitoron mediet elektronike dhe të shtypura?

Pluralizmi politik gjatë fushatave zgjedhore rregullohet nga Kodi Zgjedhor, si për servisin publik ashtu edhe për mediet private, kurse organi rregullator është i autorizuar të monitorojë raportimin e medieeve radiodifuzive. Dispozitat e Kodit Zgjedhor për detyrimet e Servisit Publik Radiodifuziv në arritjen e një ekuilibri në emisionet ditore-informative janë jashtëzakonisht komplekse. Gjegjësisht, RTM, përveç parimit të proporcionalitetit, sipas të cilit duhet të udhëhiqen të gjithë radiodifuzerët e tjerë, duhet t'i strukturojë lajmet sipas një formule të komplikuar: 30 për qind kronika mbi ngjarjet ditore nga vendi dhe bota, 30 për qind mbi aktivitetet e partive politike të pushtetit, 30 për qind për aktivitetet e partive poli-

tike nga opozita parlamentare dhe 10 për qind për aktivitetet e partive politike që nuk janë të përfaqësuara në Parlament. Sipas vlerësimit të ASHMAA-së, “kjo formulë e ngurtë matematikore ka treguar dobësitë e saj edhe në këto zgjedhje ... dhe është një barrë e tepruar, që e detyron Servisin Publik të përqendrohet në formën – të numërojë sekondat e më pas thelbin, të merret me thelbin e raportimit gazetaresk”.²⁶

A kanë partitë politike dhe kandidatët qasje të drejtë dhe të barabartë në media gjatë proceseve zgjedhore?

Nga monitorimi i zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të mbajtura më 15 korrik, 2020, ASHMAA arriti në përfundimin se Servisi Publik Radiodifuziv, në katër kanalet programore, në përgjithësi, ka siguruar ekuilibër në lajme, duke përbushur formulën e dyfishtë për ndarjen e kohës. ASHMAA-ja ka ardhur në përfundim se asnjë nga televizionet komerciale nuk ka arritur të zbatojë plotësisht parimin e raportimit në proporcion me numrin e listave të konfirmuara të kandidatëve dhe intensitetin e fushatës. Disa nga televizionet kanë bërë përpjekje për të raportuar mbi shumicën e pjesëmarrësve në fushatë, dhe disa media të tjera janë përqendruar vetëm në disa fushata.²⁷ Rezultatet e monitorimit të OSBE/ODIHR konfirmojnë që Servisi Publik është përpjekur të sigurojë qasje si për partitë kryesore po ashtu dhe për ato më të vogla parlamentare dhe jashtëparlamentare. Nga ana tjetër, mediet private, në pjesën më të madhe, janë përqendruar në partitë kryesore politike dhe, në një masë më të vogël, në partitë më të vogla parlamentare, ndërsa prezantimi i partive jashtëparlamentare ka qenë shumë i ulët.²⁸

25 Në një intervistë të thelluar të zhvilluar më dt. 12.12.2020, Dejan Georgiev nga Qendra për Zhvillimin e Mediave thekson: “Më duket se radiodifuzerët po bëjnë përpjekje të mëdha për të konsultuar pikëpamjet e partive kryesore për çdo çështje të mundshme. Nëse ata kanë intervistuar një udhëheqës të një partie politike në pushtet, ata përpiqen të intervistojnë menjëherë edhe liderët e opozitës. Një pjesë e mirë e lajmeve u referohen pseudo-ngjarjeve, respektivisht “grindjeve” midis partive politike, duke cituar deklarata nga konferencat për shtyp, sipas parimit, të parët do të dalin dhe do të akuzojnë, të tjerët do të përgënjeshtrajnë dhe do të paraqesin akuzat e tyre ose duke rikujtuar se kush çfarë ka bërë kur ka qenë në pushtet”.

26 ASHMAA, “Pasqyrë e procedurave kundërvajtëse të ngritura nga ASHMAA për zgjedhjet parlamentare të vitit 2020”; Shkup: 2020. Qasur më: 11.12.2020. <https://avmu.mk/2020-2/>

27 ASHMAA, “Raport nga prezantimi i zgjedhjeve nga mediat (24 qershor -12 korrik 2020)”; Shkup: 2020. Qasur më: 11.12.2020. <https://avmu.mk/2020-2/>

28 OSBE/ODIHR, “Republika e Maqedonisë së Veriut: Zgjedhjet e parakohshme parlamentare 15 korrik 2020 (Raporti përfundimtar)”, Varshavë: 2020. Qasur më: 25.10.2020. <https://www.osce.org/files/f/documents/0/a/471672.pdf>

A4 Liria e punës dhe bashkimi i gazetarëve

A duhet që gazetarët të licencohen nga shteti për të qenë në gjendje të punojnë?

A ka pasur ndonjë përpjekje për t'u siguruar (dhënë) leje nga shteti gjatë vitit të kaluar?

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, profesioni i gazetarisë nuk i nënshtrohet licencimit, por problemi është se Ligji për Media ende përmban një përkufizim të termimit gazetar.²⁹ SHGM-ja dhe organizata të tjera mediatike, që nga miratimi i LSHMAA në vitin 2013, reagoi se kjo mund të kufizojë ushtrimin e lirë të profesionit të gazetarisë. Përcaktimi i asaj se kush është gazetar dhe kush mund të jetë gazetar nuk duhet t'i nënshtrohet ligjit, respektivisht kjo është çështje e vetë-rregullimit.

A janë refuzuar gazetarët të raportojnë nga vende ose ngjarje të caktuara sepse nuk kanë pasur akreditim?

Në vitin 2020, gjatë konferencave për shtyp të ministrimit të Shëndetësisë lidhur me pandeminë, prania e disa gazetarëve dhe medieve ishte e kufizuar, respektivisht kishte raste kur disa gazetarë u penguan të bënin pyetje. SHGM-ja reagoi se me një praktikë të tillë të organizimit të konferencave për shtyp online, gazetarët nuk janë plotësisht të lirë të parashirojnë pyetje, as të kometojnë mbi përgjigjet e dhëna.³⁰ Më vonë, iu lejua qasja e drejtpërdrejtë në konferencat për shtyp vetëm medieve që janë pjesë e Regjistrimit të SHGM-së dhe KEMM-it, por SHGM-ja përsëri reagoi publikisht duke treguar se qëllimi i Regjistrimit është respektimi i standardeve gazetareske dhe inkurajimi i gazetarisë profesionale dhe se nuk mund të shërbejë si bazë për zgjedhjen e medieve që do t'u lejohet të raportojnë nga konferencat qeveritare për shtyp.³¹

Për mbrojtjen nga përhapja e infeksionit të virusit korona, në mars të vitit 2020, Qeveria miratoi një dek-

ret,³² që gjatë kohës së orës policore u mundësoi gazetarëve dhe punonjësve mediatik lirinë e lëvizjes pas orës 21, bazuar në një leje të lëshuar nga Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës.

Më 7 qershor 2020, rreth orës 19, gazetarja Biljana Sekullovska, redaktore e mediumit online Nova (www.novatv.mk), gjatë kryerjes së detyrave të saj profesionale, fotografoi një patrullë policie që kryente kontrollin gjatë orarit të orës policore. Pavarësisht se Sekullovska është prezantuar policisë dhe duke treguar lejen për lëvizjen e lirë gjatë orës policore, zyrtarët policorë e kanë ndaluar t'i filmojë dhe e kanë kërcënuar në mënyrë të vrazhdë se do ta padisin sepse, sipas tyre, nuk ka qenë e lejuar t'i filmojë zyrtarët policorë. Megjithatë, pas ankesës së dërguar nga SHGM-ja, Kontrolli i Brendshëm i MPB-së ka konstatuar vepër të paligjshëm të policëve për pengimin e gazetares Biljana Sekullovska në kryerjen e detyrave të saj profesionale.³³

A janë gazetarët të organizuar në shoqata profesionale dhe si? A ka presione mbi shoqatën e tyre ose mbi ndonjë nga anëtarët?

Shumica e gazetarëve janë të organizuar në shoqata profesionale. Shoqata më e madhe dhe më vjetër është Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM), e themeluar në vitin 1946, anëtare e Federatës Ndërkombëtare të Gazetarëve (FNG) dhe e Federatës Evropiane të Gazetarëve (FEG). Numri i anëtarëve të rregullt të SHGM-së kah mesi i vitit 2018 ishte 680, dhe në tetor të vitit 2019 ky numër u rrit në 860 anëtarë. Si rezultat i pandemisë dhe kufizimit të lëvizjes së qytetarëve dhe gazetarëve në vitin 2020, shënohet një rënie e lehtë e anëtarëve të rregullt të SHGM-së. Numri i anëtarëve në fund të vitit 2020 ishte 577.

A janë gazetarët të organizuar në sindikata dhe si? A ka presione ndaj drejtuesve të sindikatës dhe anëtarëve të tjerë? A mundet gazetarët të anëtarësohen lirisht në sindikata?

Lidhur me mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve, gazetarët dhe punonjësit mediatik janë të organizuar në kuadër të Sindikatës së Pavarur të Gazetarëve dhe Punonjësve Mediatik – SPGPM, e cila është e pavarur dhe nuk është pjesë e ndonjë organizate sindikalistike në nivel kombëtar. Ekziston edhe një sindikatë e

29 Në nenin 2, nocioni gazetar është përkufizuar si "person që grumbullon, analizon, përpunon ose klasifikon informacione të publikuara në media dhe është i punësuar në media ose ka marrëveshje për punë me ta, ose person që realizon aktivitetet gazetareske si profesion i pavarur (gazetar i lirë)".

30 SHGM, "Liria e shprehjes duhet të jetë e garantuar edhe gjatë gjendjes së jashtëzakonshme"; Shkup: 2020. Qasur më: 11.10.2020. <https://znm.org.mk/znm-slobodata-na-izrazuvane-mora-da-bi-3/>

31 SHGM, "Regjistri i KEMM dhe SHGM ekziston për njohjen e mediave profesionale e jo për ndarjen e leveve për lëvizje"; Shkup: 2020. Qasur më: 11.10.2020. <https://znm.org.mk/regjistarot-na-semm-i-znm-postoi-zg-prep/>

32 Qeveria e RMV, "MSHIA do të sigurojë leje ditore për punën e punonjësve mediatik pas orës 21"; Shkup: 2020. Qasur më: 18.11.2020. <https://viada.mk/node/20652>

33 SHGM, "MPB i ka ndëshkuar policët që e kanë penguar gazetaren Sekullovska"; Shkup: 2020. Qasur më: 25.09.2020. <https://bit.ly/3tHJAY7>

veçantë e servisit publik radiodifuziv, e cila nuk është pjesë e SPGPM-së. Sipas përfaqësuesve të SPGPM-së, forma më e zakonshme e presionit mbi anëtarët-gazetarë të sindikatës është kur pronarët ose menaxherët e medieve shmangin anëtarësinë sindikaliste ta përlogaritin nga paga e gazetarëve, duke bërë që ata të humbin statusin e tyre të sindikatës.

A ka një Këshill të etikës në media dhe si është i organizuar ky organ? A ka presion mbi përfaqësuesit e Këshillit të Etikës?

Këshilli për Etikë në Media (KEMM) është organ vetërrregullues, i cili ekziston që nga dhjetori i vitit 2013 dhe në të cilin, mbi baza vullnetare, janë anëtarë botuesit e medieve. Kusht për anëtarësimin në KEMM është respektimi i parimeve dhe standardeve etike të Kodit të Gazetarëve dhe pranimi i Statutit të KEMM-it. Anëtarët e KEMM-it janë të detyruar të përfshihen aktivisht në procesin e ndërmjetësimit dhe të publikojnë vendimet e Komisionit të Ankesave të këtij organi. Në fund të vitit 2019, u miratuan kriteret për pranimin e portaleve të internetit në Regjistrin e Medieve Profesionale Online,³⁴ të cilat përfshijnë: transparencën e strukturës së pronësisë, publikimin e impesumit, nënshkrimin e përmbajtjes së botuar nga gazetarët/autorët, regjistrimin e detyrueshëm të medieve online si subjekte juridike etj. Përveç KEMM-it, pranë SHGM-së funksionon edhe Këshilli i Nderit, si një mekanizëm i brendshëm vetërrregullues, i cili e monitoron respektimin e Kodit të Gazetarëve nga gazetarët anëtarë të SHGM-së.

A5 Mbrojtja e burimeve të informacioneve

Si garantohet me ligj fshehtësia e burimeve gazetareske? Nën cilat kushte mund të kufizohet e drejta për mbrojtjen e burimeve?

E drejta për mbrojtjen e burimit gazetaresk në RMV është kategori kushtetuese dhe kjo është e garantuar nga Kodi Penal, Ligji për Përgjegjësinë Civile për Fyerje dhe Shpifje, Ligjin për Mediet dhe Ligjin për Shërbimet Mediatike Audio dhe Audio-vizuale.

³⁴ Rregullat për anëtarësimin e internet portaleve në Regjistrin janë në dispozicion në: <https://www.semm.mk/chlenstvo/pravila-za-chlenstvo>

A ka shembuj të sanksioneve të shqiptuara ndaj gazetarëve që kanë refuzuar të zbulojnë identitetin e burimeve të tyre?

Në vitin 2020, nuk u regjistrua asnjë rast i sanksionimit të gazetarëve që refuzuan të zbulojnë identitetin e burimit të informacioneve. Rasti i fundit i sanksionimit të gazetarëve që refuzuan të zbulojnë identitetin e burimit të informacioneve u shënuar në 2019³⁵.

A munden gazetarët të kenë qasje dhe të realizojnë kontakte lirisht me burimet e informacioneve?

Në përgjithësi, kur punojnë në tekste hulumtuese, gazetarët ndjehen të lirë të kontaktojnë burimet e informacioneve. Me Ligjin e ri për mbrojtjen e informatorëve³⁶ rregullohen çështjet e raportimit të mbrojtur, të drejtat e informatorit, si dhe veprimet dhe detyrat e institucioneve në lidhje me raportimin e mbrojtur dhe sigurimin e mbrojtjes së informatorëve. Me ndryshimet e këtij ligji, në vitin 2018, është kryer harmonizimi me standardet ndërkombëtare të përkrahura në këtë fushë dhe i njëjti siguron mbrojtje më të madhe për informatorët. Në atë drejtim, burimet gazetareske inkurajohen dhe mbrohen më mirë nga ana institucionale. Për më tepër, nuk ka pasur raste denoncimesh në SHGM, në lidhje me shkeljet e mundshme të këtij ligji gjatë vitit 2020.

A6 E drejta për qasje në informata

Cilat janë rregullat ligjore për qasje në dokumente dhe informata zyrtare që janë relevante për gazetarët?

Parlamenti i RMV-së në maj të vitit 2019 miratoi Ligj të ri për qasje të lirë në informata me karakter publik, sipas të cilit, ish Komisioni për Mbrojtjen e së Drejtës për Qasje të Lirë në Informata me Karakter Publik u shndërrua në Agjenci, drejtori dhe zëvendësi i së cilës morën kompetenca më të mëdha në zgjidhjen e anke-

³⁵ Bëhet fjalë për aktakuzë të ngritur ndaj gazetarit të portalit Infomaks për publikimin e procesverbalit për një rast aktiv në Prokurori, dhe lidhur me këtë SHGM-ja reagoi duke theksuar se "Prokuroria nuk duhet t'i ndjekë ata që i kanë publikuar dokumentet, por personin që ka pasur qasje në dokumentet zyrtare sekrete dhe që i ka nxjerrë dhe i ka dhënë një mediumi... sepse ndjekjet e këtilla gjyqësore, në mënyrë shtesë mund të ndikojnë negativisht në lirinë e shprehjes dhe të nxisin vetëcensurë të gazetarët..."

³⁶ Ligji për mbrojtjen e sinjalizuesve (2016). Qasur më: 15.02.2020. https://mjoa.gov.mk/sites/default/files/pbl/files/documents/Upatstvo_ukazuvachi.pdf

save dhe parashtrësive nga qytetarët. Ndryshimi më i rëndësishëm për gazetarët është ulja e afatit për t'iu përgjigjur kërkesës, respektivisht për marrjen e një vendimi, nga 30 në 20 ditë, me mundësinë e zgjatjes për 10 ditë të tjera.

A i shfrytëzojnë gazetarët këto rregulla? A i respektojnë institucionet rregullat, pa vonesë?

Në raportin e saj të parë tremujor, Agjencia e Mbrojtjes së të Drejtës për Qasje të Lirë në Informata me Karakter Publik informoi se deri te kjo agjenci janë parashtruar 109 ankesa nga kërkuesit e informatave, nga të cilat dhjetëra janë nga gazetarë, dhe pjesa tjetër nga shoqata civile dhe individë. Gazetarët e angazhuar në gazetari hulumtuese ankohen për heshtjen e institucioneve, por ata, gjithashtu, theksojnë se komunikimi me zyrtarët e Agjencisë është përmirësuar, dhe se ata i kuptojnë problemet e tyre dhe u ofrojnë ndihmë në shfrytëzimin e Ligjit.³⁷ Sipas përvojave të gazetarëve të cilët kanë parashtruar kërkesa për informata në institucione,³⁸ afati për ankesë e ndërlikon edhe më shumë procesin, dhe praktika e mbajtësve të informatave me karakter publik zakonisht është të përgjigjen në ditën e fundit të afatit.

A janë autoritetet transparente, në përgjithësi? A ofrojnë ato marrëdhënie të hapura, jo-diskriminuese dhe të drejta me mediet apo preferojnë të punojnë në fshehtësi? A kanë institucionet shtetërore trajtim të privilegjuar ndaj atyre mediave që janë të përkulura politikisht ndaj tyre?

Vlerësimi i përgjithshëm i shumë ekspertëve, gazetarëve dhe organizatave është se situata me transparencën e institucioneve është përmirësuar, por gjithashtu se shteti ende nuk mund të mburret me hapjen e plotë dhe llogaridhënien e institucioneve. Analiza e përgatitur nga Qendra për Komunikime Civile,³⁹ në kontekstin e respektimit të afatit për përgjigje nga institucionet, tregon se nga gjithsej 460 kërkesa të adresuara nga Qendra për Komunikime Civile në Agjencinë e Mbrojtjes së të Drejtës për Qasje të Lirë në Informata me Karakter Publik, brenda afatit maksimal ligjor prej 20 ditësh, vetëm 51 për qind e kërkesave janë përgjigjën

(234 kërkesa). 48 për qind e kërkesave (221 kërkesa) është përgjigjur pas afatit ligjor, ndërsa 1 për qind e kërkesave (5 kërkesa), institucionet nuk janë përgjigjur as pas vendimit të Agjencisë.

Sa janë të hapura për publikun Qeveria dhe Ministrinë?

Gazetarët theksojnë se në kushtet e pandemisë, shumica e institucioneve ishin me transparencë të "kufizuar", në masën që u përshtatet atyre që drejtojnë institucionin. Numri më i madh i ministrive janë vonuar me njoftimet dhe kumtesat e tyre, kurse shërbimet e marrëdhënieve me publikun shpesh kërkonin të impononin interesin ose perspektivën e tyre me raportimin e tyre. Shpesh ka ndodhur që bartësit e funksioneve të jenë, madje, më transparentë sesa shërbimet e tyre të marrëdhënieve me publikun, të cilat kanë qenë mjaft të mbyllura.⁴⁰ Megjithatë, në përgjithësi, vlerësohet se transparenca në vitin 2020 ishte më e lartë se në vitet e mëparshme. Vlerësohet se Qeveria e RMV-së ka rritur transparencën në krahasim me institucionet e tjera shtetërore.

A janë gjykatat transparente? A kanë mediet qasje në procedurat gjyqësore pa diskriminim dhe pa kufizime të panevojshme?

Gjykatat në Shkup, sipas gazetarëve, kanë transparencë dukshëm më të madhe krahasuar me gjykatat tjera në territorin e vendit. Gjykatat jashtë qytetit të Shkupit shpesh edhe nuk kanë shërbim për marrëdhënie me publikun dhe me shkathtësi shmangin gazetarët lokalë, dhe kur bëhet fjalë për pyetje nga gazetarë nga mediet më të mëdha në Shkup, ata janë më të hapur për të dhënë informata. Disa gazetarë, nga ana tjetër, kanë parashtruar ankesa në SHGM për pengimin e raportimit të tyre nga procedurat që zhvillohen në Gjykatën Themelore Civile në Shkup. Pas reagimit të SHGM-së, Kryetari i Gjykatës deklaroi se disa prej gazetarëve nuk u lejohej të ishin fizikisht të pranishëm në sallat e gjyqit sepse ata nuk kanë parashtruar kërkesë në kohë për atë qëllim, në përputhje me Rregulloren e Gjykatës. Sidoqoftë, shtrohet pyetja pse ky nuk ishte problem më parë dhe pse nuk ka kufizime të tilla në Gjykatën Penale në Shkup, për të cilën nuk kishte ankesa nga gazetarët. Kur bëhet fjalë për Prokurorinë Publike, përvoja e gazetarëve është se "... nuk ka praktikë të dhënies së informatave të hollësishme dhe në kohë".⁴¹

37 Fondacioni Metamorfozis, "Raport final – përmbledhës i vëzhgimit të përmbushjes së prioritetve reformuese nga sfera e mediave (2019-2020)", Shkup: 2020. Qasur më: 25.12.2020. https://mediaobservatorium.mk/wp-content/uploads/2020/12/OMR-finalen-011119-15.12.20.pdf?fbclid=IwAR2T-XkP-i6visJUy8m1a_qwidmBySzMma9bY80M3ZUJw74cUJrp0FKQ

38 Fokus grupe me gazetarë të 12 mediave, të organizuara më dt. 24.12.2020 dhe 29.12.2020.

39 Qendra për Komunikime Civile, "Analiza e zbatimit të Ligjit të ri për qasje të lirë në informata me karakter publik", Shkup: 2020. Qasur më: 25.11.2020. <https://www.ccc.org.mk/images/stories/aspmpk.pdf>

40 Fokus grupe me gazetarë të 12 mediave, të organizuara më dt. 24.12.2020 dhe 29.12.2020.

41 Deklaratë e një gazetari në fokus grupin e organizuar më dt. 24.12.2020.

A është siguruar qasje e publikut në seancat parlamentare? A ka kufizime për gazetarët që mbulojnë punën e Parlamentit?

Ekziston një mendim i përgjithshëm se Kuvendi i RMV-së është më transparent, megjithëse shpesh ndodh të ketë prolongim në përgjigjet e kërkuara. SHGM-ja, vitin e kaluar, disa herë i ka dërguar shkresa Parlament për dhënien e informatave, por, me gjithë reagimet dhe urgjencat deri në fund të vitit 2020, e njëjta ende nuk ka marrë përgjigje. Nga ana tjetër, autoritetet lokale, gjatë vitit 2020, kanë treguar shkallë më të ulët transparence, kryesisht duke shfrytëzuar pandeminë dhe burimet e kufizuara si justifikim.

Për të përmirësuar qasjen e gazetarëve në informata me karakter publik, në vitin 2020 SHGM-ja filloi vendosjen e bashkëpunimit me institucione të caktuara publike. U nënshkruan Memorandume Bashkëpunimi me Entin Shtetëror të Revizionit (ESHR) dhe me Komisionin Rregullator për Energjetikë. Kjo iniciativë e SHGM-së është e rëndësishme, si për avancimin e transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve, po ashtu edhe për përmirësimin e qasjes së gazetarëve në materiale profesionale gjatë përgatitjes së analizave dhe hulumtimeve gazetareske.⁴²

⁴² SHGM, "SHGM dhe Komisioni Rregullator nënshkruan Memorandum Bashkëpunimi", Shkup: 2020. Qasur më: 20.09.2020. <https://znm.org.mk/11697-2/>

B1 Kufizimet ekonomike në punën gazetareske

Sa gazetarë kanë nënshkruar kontrata pune? A kanë mbrojtje adekuate sociale? Sa janë të larta pagat e gazetarëve? A paguhen rregullisht?

Nuk ka të dhëna të sakta rreth asaj se sa gazetarë kanë kontrata pune, por vlerësimi i përgjithshëm është se shumë gazetarë në mediet private, kryesisht, kanë kontrata me kohë të caktuar ose me kontrata për punë me honorar. Situata tashmë e vështirë socio-ekonomike e gazetarëve u përkeqësua më tej nga pandemia e shkaktuar nga virusi korona. Që nga fillimi i pandemisë, shumica e medieve kanë ulur pagat e gazetarëve dhe punonjësve mediatik, dhe shumë gazetarë janë ankuar se, ashtu si në vitet e mëparshme, nuk u janë paguar kontributet e sigurimit pensional dhe social.⁴³ Të ardhurat e ulëta, si dhe mosrespektimi i plotë i Ligjit për Marrëdhëniet e Punës nga ana e punëdhënësve, janë problemet më të zakonshme me të cilat përballet komuniteti mediatik për vite me radhë. Shumica e gazetarëve kanë të ardhura mujore shumë më pak se paga mesatare në vend, që në prill të vitit 2020 ishte 25,830 denarë. Shumica e gazetarëve dhe punonjësve mediatik marrin pagë prej 15,000 deri në 20,000 denarë. Kjo konfirmohet edhe nga sondazhi i Sindikatës së Pavarur të Gazetarëve dhe Punonjësve Mediatik (SPGPM), i kryer në 150 të anketuar.⁴⁴ Situata në servis publik është pak më

⁴³ Deklaratë e gazetarëve- pjesëmarrës në fokusin grupin e organizuar më dt. 24.12.2020.

⁴⁴ SPGPM, "Gazetarët dhe punonjësit mediatik me paga shumë të ulëta se paga mesatare", Shkup: 2020. Qasur më: 10.08.2020. <https://bit.ly/3t1tpkd>

e mirë, ku paga mesatare e gazetarëve në vitin 2020 ishte 38,120 denarë, megjithëse konsiderohet se pagat e gazetarëve, veçanërisht atyre që nuk janë fillestarë, janë më të ulëta se pagat e gazetarëve në televizionet nacionale private.⁴⁵

**Cilat janë kushtet e punës të gazetarëve?
Cilat janë problemet më të mëdha me
të cilat përballen në vendin e punës?**

Gazetarët vazhdojnë të punojnë jashtë orarit të punës dhe kjo nuk u paguhet, dhe punojnë pa kompensim edhe gjatë festave dhe fundjavave. Një tipar i këtij viti ishte që një pjesë e gazetarëve, për shkak të pandemisë, punonin nga shtëpia, kurse ata nga redaksitë më të mëdha, të tilla si televizionet nacionale, punonin me ndërrime. Për disa gazetarë, puna në kushte pandemie ua bëri edhe më të vështirë kryerjen e detyrave të tyre profesionale, veçanërisht për ata që ishin të ekspozuar ndaj situatave stresuese kur raportin nga institucionet shëndetësore dhe spitalet. Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Punonjësve Mediatik (SPGPM) është nënshkruese e Kartës së Federatës Evropiane të Gazetarëve për kushtet e punës së gazetarëve. Karta, si dhe deklarata në mbështetje të draft-kontratave të punës u nënshkruan nga Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, Këshilli për Etikë në Media në Maqedoni, Onlimit Media dhe media digjitale Vidi vaka. Karta për kushtet e punës për gazetarët⁴⁶ u hartua nga Federata Evropiane e Gazetarëve dhe u referohet kushteve të punës për gazetarët dhe punonjësit mediatik, si dhe standardeve profesionale dhe etike. Kjo kartë përmban 10 nene: liria e bashkimit, e drejta për kontratë me shkrim, e drejta për negociata kolektive, mos-diskriminimi gjatë punësimit, e drejta për pushim dhe përfundim, e drejta për mbrojtjen e burimeve gazetareske, e drejta për të mos nënshkruar përmbajtje të caktuar, siguri dhe mbrojtje, qeverisja e mirë dhe standardet etike dhe kushtet e denja për punë.

B2 Pavarësia redaktuese në mediet private

A kanë miratuar mediet private dokumente organizative që u lejojnë redaksive të jenë të ndara dhe të pavarura nga strukturat e menaxhimit dhe marketingut? A kanë krijuar mediet private rregulla për pavarësinë redaktuese nga pronarët e medieve dhe organet drejtuese? A respektohen ato rregulla?

Nuk ka të dhëna ose pasqyrime të publikuara nga të cilat mund të përcaktohet se sa media private kanë akte ose rregulla të brendshme organizative, sipas të cilave kolegji i redaktues është i ndarë formalisht nga drejtuesit e medies. Nga të dhënat që i disponon SHGM-ja dhe nga përgjigjet e marra përmes bisedave me gazetarë, mund të konstatohet se akte të tilla rrallë ekzistojnë. Në mediet më të mëdha, është e zakonshme që redaksitë të jenë të ndara nga strukturat menaxheriale, por shpesh ndodh që drejtorët të bëjnë presion ndaj redaksive në lidhje me detyrimin për të punuar në mënyrën që të siguroheshin më shumë të ardhura nga sponsorizimet ose reklamat. Kur bëhet fjalë për mediet më të vogla lokale, situata është edhe më e komplikuar, respektivisht presionet shprehen në një mënyrë tjetër dhe vijnë më shumë nga të fuqishmit lokalë. Gazetarët madje ankohen se "... ka një marrëveshje të heshtur për të shmangur tema të caktuara".⁴⁷

A kanë aprovuar mediet private kode të brendshme të etikës apo i përmbahen Kodit të përgjithshëm të etikës?

Kodi i vetëm që zbatohet për të gjithë gazetarët profesionistë është Kodi i Gazetarëve të Maqedonisë, i miratuar në vitin 2001, sipas të cilit vepron Këshilli i Nderit i SHGM-së dhe Komisioni i Ankesave pranë Këshillit për Etikë në Media në Maqedoni. Nuk ka të dhëna rreth asaj që mediet private kanë kodet e tyre specifike të etikës ose rregulla. Këshilli për Etikë në Media në Maqedoni (KEMM) së fundmi hartoi Udhëzime për raportimin etik të medieve online,⁴⁸ respektivisht udhëzime për zbatimin e Kodit të Gazetarëve në sferën online.

45 *Kategori veçanërisht e rrezikuar janë korrespondentët e RTM, të cilët janë në numër më të vogël dhe kryesisht kanë kontrata për angazhim të përkohshëm, të cilat kontrata lehtë mund të anulohen. Në nëntor të vitit 2019 u publikua shpallje për angazhim me honorar për dhjetë korrespondentë, që është progres për RTM, edhe pse SHGM-ja përpiqet për model ndryshe, me të cilin në mënyrë sistematike dhe të përhershme do të zgjidhej situata e kësaj kategorie të gazetarëve. Shih më shumë: SHGM, "Dokument për politika publike: Statusi dhe nevoja e korrespondentëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut", Shkup: 2019. Qasur më: 16.12.2020. <https://bit.ly/3eIQYNd>*

46 *Federata Evropiane e Gazetarëve, "Karta për kushtet për punë të gazetarëve". Qasur më: 20.08.2020. <https://bit.ly/3yaHk5S>*

47 *Deklaratë e një gazetari që ishte pjesëmarrës në fokus grupin e organizuar më at. 24.12.2020.*

48 *KEMM, "Udhëzime për raportim etik të medieve online – Zbatimi i Kodit të gazetarëve në online-sferën", Shkup: 2020. Qasur më: 16.12.2020. <https://bit.ly/2RRdYZP>*

Cilat janë format më të zakonshme të presionit nga pronarët dhe menaxherët e medieve ndaj redaksive apo gazetarëve të caktuar? Cili ishte shembulli më ilustrues i presionit nga pronarët e medieve ose drejtuesit e medieve ndaj një redaksie apo një gazetari gjatë vitit të kaluar?

Ekzistojnë njohuri konkrete për presion nga menaxhmenti ndaj gazetarëve, por gazetarët rrallë e raportojnë atë. Presionet zakonisht nuk shprehen si kërcënime të drejtpërdrejta, por janë subtile dhe pak të dukshme. Gazetarët vazhdojnë të mos i padisin redaktorët dhe pronarët e medieve kur shkelen të drejtat e tyre. Për shembull, vitin e kaluar nuk kishte asnjë çështje të hapur gjyqësore ku një gazetar paditë një menaxher për mobing dhe, gjithashtu, nuk kishte asnjë aktgjykim të plotfuqishëm për vepër të këtyllë. Nga ana tjetër, lidhja midis pronarëve të medieve të caktuara dhe qendrave të fuqishme shpesh është në dëm të gazetarëve që punojnë në këto medie. Megjithatë Rregullatori mediatik nuk ka treguar lidhshmëri të tillë ose përqendrim të fshehtë mediatik në vitet e fundit, shpesh në publik është raportuar se disa media radiodifuzive nacionale kanë vetëm pronar formal prapa të cilit qëndrojnë qendra të fuqisë të lidhura me elitën e biznesit dhe partitë politike.

Në vitin 2020, SHGM-ja nuk ka regjistruar raste të pashmimit/ndërprerjes së punës së gazetarëve, por nuk përfshihet mundësia që të kish pasur raste të tilla e të mos raportohen për shkak të frikës. Gazetarët-pjesëmarrës në fokus grupet e realizuara për nevojat e këtij studimi theksuan shembuj të tillë:

– Dy kolegë të rinj u punësuan në televizionin e ri lokal, njëra ... kolege me përvojë me shpresë se do të punojë shkëlqyeshëm. Pas një kohe, redaktori i ka reaguar asaj se ka bërë pak tekste, se duhej t'i kishte bërë tekstet ndryshe, se nuk meriton as 6.000 denarë për punën e saj. Dhe bashkëpunimi u ndërpre. Nga i njëjti televizion, një kolegj tjetër, pas 45 ditësh punë në televizion, nuk ka marrë asnjë pagë, por vetëm premtime boshe. Presion për temat që nuk do të trajtohen. Në mediet lokale, gjërat janë aq të përziera sikur të ketë një marrëveshje të heshtur për të mos trajtuar tema të caktuara. Kjo është arsyeja pse ekziston një reagim i tillë ndaj parave publike në media. Ka media lokale që janë plotësisht të varura nga ato para. Gazetarit nuk i shkon ndërmend të shkruajë për ato çështje. Qeveria është përpjekur të jetë transparente, duke bombarduar me informacione, ndërsa frenon kur u kërkoni atyre diçka.⁴⁹

49 Deklaratë e një gazetari që ishte pjesëmarrës në fokus grupin e organizuar më dt. 29.12.2020.

B3 Pavarësia redaktuese në servis publik

A ka miratuar servisi publik radiodifuziv një kod sjelljeje për gazetarët dhe pavarësinë redaktuese? A i përmbahen gazetarëve këtij Kodi?

Në vitin 2017, pas disa vite paralajmërime, servisi publik miratoi Kodin e Etikës për gazetarët, stafin krijues dhe të gjithë punonjësit e RTM-së.⁵⁰ Ky Kodi, i cili ka qenë në fuqi për gati katër vjet, është kritikuar që në fillim nga komuniteti i gazetarëve për përmbajtjen e dokumentit, por edhe për mungesën e transparencës në hartimin e tij. Mangësia më e madhe e Kodit është ndërhyrja e etikës gazetareske në disiplinën e punës dhe në të drejtat dhe detyrimet e gazetarëve që burojnë nga marrëdhëniet e punës. Komisioni Etik pranë RTM-së, i cili është përgjegjës për marrjen e ankesave për shkelje të mundshme të Kodit, nuk po funksionon.⁵¹ SHGM-ja reagoi dhe kërkoi ndryshim në Kodin Etik të RTM-së, krijimin e një komisioni etik, si dhe përcaktimin e procedurave për punën e tij dhe për parashtimin e ankesave që do të publikohen në ueb faqen e RTM-së. Përveç Kodit të Etikës, grupi i punës, në kuadër të projektit të mbështetur nga Ambasada Britanike në Shkup, përgatiti parime etike dhe profesionale – udhëzime të RTM-së për mbulimin mediatik të proceseve zgjedhore.⁵² Një numër i gazetarëve në servis publik e theksojnë faktin se “gjëja më e rëndësishme në këtë moment është heqja e ndikimit partiak në këtë servis. Puna dhe politika redaktuese në servis publik duhet të jenë autonome dhe e pavarur”.⁵³

A kanë vendosur rregulla të brendshme organizative organet e servisit publik radiodifuziv në mënyrë që të mbrojnë pavarësinë e redaksive nga ndikimi i organeve drejtuese? A respektohen ato rregulla?

Servisi Publik ka miratuar aktet e veta të brendshme organizative, sipas të cilave redaksitë zyrtarisht janë të ndara nga strukturat udhëheqëse. Megjithatë, në ueb faqen e Radio-Televizionit të Maqedonisë nuk mund të gjenden informacione për rregullat në përbërjen e bre-

50 RTM, “Kodi Etik i RTM për gazetarët, kuadrot kreativë dhe për të gjithë të punësuarit në RTM”, Shkup: 2017. Qasur më: 12.12.2020.

51 Komisioni deri më tani ka zgjidhur vetëm një rast të suspendimit të një gazetari dhe për një procedurë disiplinore dhe nuk ka informacione nëse ka pasur edhe raste të tjera.

52 RTM, “Parimet etike dhe profesionale të RTM për mbulim mediatik të proceseve zgjedhore”, Shkup: 2016. Qasur më: 12.09.2020. <http://mrt.com.mk/node/29490>

53 Deklaratë e një gazetari që ishte pjesëmarrës në fokus grupin e organizuar më dt. 29.12.2020.

ndshme organizative. Si në vitet e mëparshme, edhe në vitin 2020 mund të thuhet se ndryshimet e pritshme thelbësore në strukturën e brendshme të servisit publik, që supozohet të ishin pjesë e procesit të reformës në media, nuk janë bërë.

Cilat janë format më të zakonshme të presionit të Qeverisë mbi redaksitë apo gazetarëve individualë në servisin publik radiodifuziv?

Nuk mund të thuhet se RTM-ja ose gazetarët në redaksitë e saj kanë qenë nën ndikimin e drejtpërdrejtë të pushtetit në vitet e fundit. Është e njohur për publikun se udhëheqja aktuale e RTM-së u zgjodh në periudhën kur partia politike opozitare VMRO-DPMNE ishte në pushtet dhe kur presionet mbi servisin publik ishin shumë më të theksuara. Prandaj, në kërkesat për reforma në media, u theksua në mënyrë të përsëritur se nevojitet departizimi i servisit publik, respektivisht zgjedhja e një Këshilli të ri Programor dhe organeve të reja udhëheqëse. Megjithatë, si një formë e tërthortë e presionit mund të trajtohet ajo që buxheti i ndarë për servisin publik u zvogëluar në rreth 0.5%, megjithëse fondet e nevojshme për funksionimin e tij efikas vlerësohen në rreth 1%. Kjo e minon si stabilitetin ashtu edhe pavarësinë redaktuese të RTM-së nga pushteti.

B4 Pavarësia redaktuese në sektorin jofitimprurës

A kanë miratuar mediet jofitimprurëse një Kod të sjelljes për gazetarët dhe për pavarësinë redaktuese? A i përmbahen gazetarët këtij kodi?

Ato media-online që financohen kryesisht ose tërësisht me ndihmë nga donatorët dhe merren me gazetari hulumtuese, si dhe radiostacione që transmetojnë shpesh përmbajtje të të rinjve në internet, bëjnë pjesë në grupin e medieve jofitimprurëse. Gjithashtu radiot studentore, të cilat aktualisht veprojnë brenda dy universiteteve shtetërore, Universiteti “Kirili dhe Metodi” në Shkup dhe Universiteti “Goce Delçev” në Shtip konsiderohen si media transmetimi jofitimprurëse. Redaksitë e këtyre medieve janë të vogla dhe përfshijnë disa gazetarë, të cilët punojnë çdo ditë, kurse financimi është i paqëndrueshëm, duke pasur parasysh që këto media varen nga donacionet dhe grantet e huaja. Disa prej medieve informative jofitimprurëse në internet janë regjistruar si shoqata të qytetarëve dhe deri më tani nuk është kryer asnjë analizë e detajuar e punës së tyre dhe statusit dhe pavarësisë së gazetarëve në to.

Nuk ka një kod specifik të sjelljes për gazetarët në sektorin jofitimprurës, por në dhjetor të vitit 2020 Këshilli për Etikë në Media (KEMM) miratoi Udhëzimet për Raportimin Etik të Medieve Online, të cilat, në fakt, elaborojnë zbatimin e parimeve themelore etike të Kodit të Gazetarisë në sferën online. Për më tepër, KEMM dhe SHGM themeluan Regjistrin e Medieve Profesionale Online, i cili tashmë përfshin një numër të medieve informative online, përfshirë edhe ato jofitimprurëse.

Cilat janë format më të zakonshme të presionit ndaj medieve në sektorin jofitimprurës? Cili është shembulli më i ilustrues i presionit ndaj medieve në sektorin jofitimprurës?

Presioni mbi mediet jofitimprurëse, disa prej të cilave mbulojnë gazetarinë hulumtuese, ka rënë krahasuar me periudhën deri në vitin 2016, kur gazetarët dhe redaktorët nga këto media shpesh diskreditohehin publikisht në bazë personale dhe ndaj tyre përdorej gjuhë urrejtjeje për shkak të teksteve kritike për autoritetet e atëhershme dhe të fuqishme. Shumica e këtyre medieve e kanë pranuar ose kanë vepruar në përputhje me Kodin e Etikës dhe udhëzimet për raportimin etik në mediet online, për zbatimin e të cilave kujdeset KEMM-i.

Sidoqoftë, ka ende shumë shembuj të kërcënimeve ndaj gazetarëve ose aktivistëve të shoqërisë civile në rrjetet sociale dhe disa prej tyre janë raportuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB). Në mënyrë të veçantë, denoncimet janë dorëzuar në Sektorin për krim kompjuterik dhe forenzikë digjitale pranë Shërbimeve Qendrore të Policisë, me kërkesë për procesim, por pothuajse asnjë rast nuk mori një përfundim gjyqësor, edhe pse në disa raste kishte kërcënime të qarta. Për disa nga rastet, MPB-ja e informoi SHGM-në se nuk është kompetente të veprojë me udhëzim juridik, dhe që palët e dëmtuara të ngrenë padi private për rrezikimin e sigurisë personale.

Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM) dhe Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Punonjësve Mediatik (SPGPM) reagues ndaj komunikimit të papërshtatshëm të klinikës “Acibadem Sistina” me gazetarët nga redaksia e platformës së gazetarisë hulumtuese IRL (rl.mk) me rastin e strosjes së tyre për Covid-19 të titulluar “Përfitim pandemie ose kujdes ndaj komunitetit: Ana tjetër e rrëfimit për testet Covid-19”, botuar më 28.03.2020. Si palë e prekur në tekst, “Acibadem Sistina” dërgoi një reagim në redaksinë e IRL-së, që është e drejtë e tyre legjitime, por gjithsesi problematike në kërkesën e tyre është se ata shpifin dhe i fyejnë gazetarët që kanë punuar në këtë storje hulumtuese, dhe gjatë kësaj pa argumente të mjaftueshme në reagimin e tyre kërkojnë që t’u kërkohet ndjesë dhe tërheqje të tekstit të IRL. SHGM dhe SPGPM vlerësuan se kjo qasje e “Acibadem Sistina”

është e papranueshme. Me këtë mënyrë komunikimi, ata depërtojnë drejtpërdrejt në besueshmërinë e gazetareve dhe përpiqen t'i diskreditojnë ata e jo të argumentojnë kritikën e drejtuara ndaj tyre.

B5 Liria e gazetareve në procesin e prodhimit të lajmeve

Sa liri kanë gazetaret në zgjedhjen e storjeve gazetareske për të cilat do të punojnë dhe në vendimmarrjen se cilat aspekte të një storjeje duhet të theksohen? Sa shpesh gazetaret marrin pjesë në redaktimin dhe koordinimin e politikës redaktuese (pjesëmarrja në takime redaktuese ose në emërimin e gazetareve)?

Sipas deklaratave të bashkëbiseduesve në intervista dhe në fokus grupe, gazetaret gjatë vitit 2020 kishin më shumë liri në zgjedhjen e temave për të cilat do të raportojnë.⁵⁴ Megjithatë, zgjedhja e temave për raportim në mediet rajonale dhe lokale është një problem më i madh për gazetaret për shkak të mjedisit të vogël në të cilin veprojnë këto media, për shkak të lidhjeve të vendosura klienteliste të pronarëve me kryetarët e komunave dhe autoritetet e tjera lokale, si dhe për shkak të përkeqësimit të situatës financiare në të cilën ndodhen këto media. Flitet hapur edhe për ndikimin e disa prej redaktorëve të gazetareve, në kuptimin që ai ndikim në punën e përditshme nuk është aq i dukshëm, respektivisht se ka më shumë vetë-censurë sesa presione të drejtpërdrejta.

Cili është perceptimi i vetë gazetareve në lidhje me atë se sa ndikohen nga rreziqet dhe burimet e ndryshme të ndikimit? A e raportojnë gazetaret censurën nga ana e redaktorëve A janë gazetaret subjekt i vetë-censurës nga frika e humbjes së punës ose për shkak të presioneve të tjera?

Gazetarët e intervistuar thonë se problemi më i madh është se pronarët e medieve këtë veprimtari nuk e kanë biznes themelor. Më shpesh, prapa mediumit qëndrojnë kompani të tjera që, nga ana tjetër, janë të lidhura me tënderë me ministri dhe institucione dhe nga ky aspekt ka tema tabu për media të caktuara. Kjo është theksuar po-

54 Veçse ishte deklarata e njërit prej pjesëmarrësve në fokus grupet: "Mund të toleroj pagën e ulët, pikërisht për shkak të lirisë që e kam në përzgjedhjen e temave, të shkruaj për gjithçka që më intereson. Kemi liri të plotë, pa asnjë censurë. Kjo më ndihmon të ndërtohem si gazetarë." (Fokus grupi i organizuar më dt. 24.12.2020).

saçërisht në mediet lokale, dhe si ilustrim për këtë njëri nga pjesëmarrësit në fokus grup vuri në dukje shembullin sipas të cilit "në Ohër kishte një këshilltar i përfshirë në ndërtimet e paligjshme në Liqenin e Ohrit, për të cilin mediet e Ohrit kanë frikë të shkruajnë."⁵⁵

B6 Pozita ekonomike e gazetareve femra

A punojnë gazetaret femra në kushte më të këqija të punës krahasuar me kolegët e tyre meshkuj? A nënshkruajnë kontrata pune aq shpesh sa edhe gazetaret meshkuj?

Vlerësim i përgjithshëm është se pozicioni i gazetareve në redaksi nuk ndryshon shumë nga pozicioni i gazetareve. Nuk ka të dhëna se sa gazetare dhe gazetarë kanë nënshkruar kontrata pune, por konsiderohet se punëdhënësit, në përgjithësi, kur bëhet fjalë për gazetarë që punojnë në kohë të pacaktuar, i respektojnë të drejtat themelore të grave që janë parashikuar me ligj, siç është pagesa e pagave, pushimi i lehonisë dhe pushimi i paguar. Sidoqoftë, ka media në të cilat edhe gazetareve edhe gazetareve nuk paguhen ditët e festave, puna gjatë fundjavës dhe orët shtesë.

A janë femrat në pozicione drejtuese në redaksi ashtu si meshkuj?

Sipas rrëfimeve të vetë gazetareve, në përgjithësi, mundësitë që femrat të zhvillohen si gazetarë profesioniste dhe të avancojnë në karrierën e tyre nuk janë shumë më të vogla krahasuar me mundësitë e kolegëve të tyre meshkuj.⁵⁶ Të dhënat e disponueshme për sektorin audio-vizual e konfirmojnë këtë përfundim: në redaksitë televizive, gratë janë edhe më të shumta se kolegët e tyre gazetarë. Kështu, në fund të vitit 2018, në mediet radiodifuzive kishte gjithsej 540 gazetarë femra dhe 370 gazetarë meshkuj,⁵⁷ kurse numri i redaktorëve meshkuj dhe redaktoreve gra ishte pothuajse i barabartë – 105 gra dhe 108 burra në pozicione të redaktorëve.

55 Deklaratë e një gazetari që ishte pjesëmarrës në fokus grupin e organizuar më dt. 29.12.2020.

56 Sanja Trajkovska Dimitrova, "Pozita strukturore e grave gazetarë në mediat në Maqedoni", Shkup: IMM, 2018, fq. 6. Qasur më: 09.03.2020. https://www.mim.org.mk/attachments/article/1136/Strukturanota%20opolzba%20na%20zenite-novinari%20vo%20mediumite_fin.pdf

57 ASHMAA, "Struktura e të punësuarve në industrinë mediatike audio dhe audiovizuale në vitin 2018", Shkup: 2019. Qasur më: 09.03.2020. <https://avmu.mk/wp-content/uploads/2019/09/Структура-на-вработените-во-аудио-и-аудиовизуелна-медийска-индустрија-во-2018-година.pdf>

Megjithatë, kur bëhet fjalë për pozitat udhëheqëse në media, dominimi mbetet me burrat.

Në përgjithësi, kushtet e punës janë të njëjta, të paktën në redaksitë ku kam punuar unë (Makfax, Sloboden pečat, Nezavisen ...). Ajo që është e rëndësishme është që ka padyshim më shumë gra gazetarë dhe ka më shumë burra në pozicione të redaktorëve. Kjo bën diferencën në status. Lidhur me tendencën e gazetarëve të zënë pozicione drejtuese të redaktoreve po aq sa burrat, mendoj se numri i redaktoreve gra është rritur kohët e fundit (24 çasa, Fokus, Sitel ...), por ende nuk është arritur një ekuilibër. Deklaratë nga Slobodanka Jovanovska, redaktore në gazetën Nezavisen.

Sa janë pagat e tyre në krahasim me pagat e kolegëve gazetarë? A përballen gratë gazetare me presione specifike mbi baza gjinore në redaksitë?

Pagat e gazetarëve ndryshojnë në varësi të pozicionit të gazetarit dhe nuk ka dallim nëse janë gazetarë meshkuj apo femra. Sipas analizës dhe hulumtimit të SPGPM,⁵⁸ paga mesatare neto e gazetarëve është 350 euro në dy vitet e fundit. Nuk ka të dhëna të sakta për pagën mesatare të redaktorëve. Të dhënat tregojnë se në vitin 2020, shumica e gazetarëve dhe punonjësve mediatik marrin pagë prej 15,000 deri në 20,000 denarë (35.3 për qind marrin pagë ndërmjet ose 244-325 euro), ndërsa 30.6 për qind e të anketuarve thanë se marrin pagë mujore midis 20 dhe 25 mijë denarë (325-405 euro). Rreth 5 për qind e të anketuarve thanë se të ardhurat e tyre janë nën 15,000 denarë në muaj (nën 244 euro). Kjo do të thotë që 70 për qind e gazetarëve në Maqedoni marrin pagë mujore nën pagën mesatare. Sipas të dhënave të Entit Shtetëror të statistikës për prillin e vitit 2020, paga mesatare ishte 25,830 denarë ose (419 euro).

⁵⁸ SPGPM, "Gazetarët dhe punonjësit mediatik me pagë shumë më të ulët se ajo mesatare", Shkup: 2020. Qasur më: 10.08.2020. <https://bit.ly/3tltpkd>



C1 Statistika e sigurisë dhe mosndëshkimit

Sipas statistikës së SHGM-së, nga fillimi i vitit 2020 janë shënuar gjithsej 14 sulme dhe kërcënime të vrazhda ndaj gazetarëve, nga të cilat më shumë së gjysma e tyre janë ndaj gazetarëve. Për krahasim, vitin e kaluar incidente të këtilla kishte vetëm katër, që do të thotë se këtë vit sulmet dhe kërcënimet janë tre herë më të shumta. Edhe pse numri i sulmeve fizike është zvogëluar, prapëseprapë shqetëson fakti që vërehet rritje e numrit të kërcënimeve për jetën e gazetarëve në rrjetet sociale. Në këtë drejtim, orvatje plotësuese duhet të bëjë edhe Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) për sanksionim të fajtorëve, ndërsa për rastet më serioze të kërkojë nga Prokuroria Themelore Publike (PTHP) të ngrëjë procedura penale.

Përndryshe, në periudhën prej vitit 2018 deri në vitin 2020, në Regjistrin e SHGM-së janë regjistruar gjithsej 21 sulme të gazetarëve dhe punonjësve mediatik, nga të cilët tre sulme janë vërejtur në vitin 2018, në vitin 2019 janë regjistruar katër, ndërsa në vitin 2020, 14 sulme mbi gazetarët dhe punonjësit mediatik.

Në kategorinë e parë të sulmeve bëjnë pjesë dy rastet e sulmit verbal mbi redaktoren e TV Alfa, Iskra Koroshevska dhe mbi gazetaren dhe zëvendës redaktoren e portalit A1on, Meri Jordanovska, nga ana e Emil Jakimovskit, ish i punësuar në Regjistrin Qendror të Maqedonisë dhe anëtar i VMRO-DPMNE-së. Në të dy rastet bëhet fjalë për kërcënime të cilat përmbajnë edhe diskriminim gjinor, që është sulm serioz, si mbi lirinë e shprehjes, ashtu edhe mbi dinjitetin e dy gazetareve. Në lidhje me porositë kërcënuese drejtuar nëpërmjet rrjeteve sociale u ngrit parashtresë deri te Prokuroria

Tabela 2. Numri i sulmeve të regjistruar mbi gazetarë në vitin 2020

Kategoritë	Numri	Përshkrimi
<p>Kërcënime dhe maltretime që nuk kanë të bëjnë më sigurinë fizike të gazetarëve Kjo kategori e kërcënimeve dhe maltretimeve përfshin: – vëzhgim ose ndjekje; – thirrje telefonike shqetësuese; – shqetësim arbitrar gjyqësor ose administrativ; – deklarata agresive nga nëpunësit publikë; – forma tjera të presionit që mund ta kërcënojnë sigurinë e gazetarëve gjatë kryerjes së punëve të tyre. Këto lloj kërcënimesh nuk përfshijnë mobingun dhe dhunën në ambientet e punës.</p>	7	<ul style="list-style-type: none"> - Kërcënime dhe ofendime ndaj gazetares së A1on, Meri Jordanovska nga Emil Jakimovski; - Kërcënime dhe ofendime drejtuar redaktores së TV Alfa, Iskra Koroshevska nga Emil Jakimovski; - Pas përfundimit të intervistave me liderët e VMRO-DPMNE-së dhe LSDM-së, një person me emrin Boban Petrevski ka dërguar porosi kërcënuese deri te gazetari i TV24, Mishko Ivanov; - Nëpunës të policisë nga sigurimi i ish ministrit të Punëve të Brendshme, Naqe Çulev e kanë kërcënuar gazetarin Furkan Saliu nga TV Klan; - Gazetarja Miroslava Burns është kërcënuar nëpërmjet Facebookut për shkak të një teksti për një dasmë në Tetovë, gjatë kohës së epidemisë me Covid-19; - Gazetarja Aneta Dodevska nga TV24 ka marrë më shumë kërcënime nëpërmjet rrjeteve sociale; - Gazetarja Natasha Stojanovska nga TV Telma ka paraqitur kërcënime dhe shqetësime nëpërmjet rrjeteve sociale.
<p>Kërcënime për jetën dhe sigurinë fizike të gazetarëve Ky lloj kërcënimesh përfshin: – kërcënime me vdekje ndaj gazetarëve, miqve të gazetarëve, anëtarëve të familjeve të tyre ose burimeve të informatave; – Kërcënime për lëndime fizike ndaj gazetarëve, miqve të gazetarëve, anëtarëve të familjeve të tyre ose burimeve të informatave. Këto kërcënime mund të jenë: – të drejtpërdrejta ose nëpërmjet personave të tretë; – të dërguara nëpërmjet rrugës elektronike ose drejtpërdrejt sy – më – sy; – implicite, por edhe eksplicite.</p>	3	<ul style="list-style-type: none"> - Kërcënime nëpërmjet telefonit drejtuar gazetares së TV21 Almedina Ismajli, drejtuar nga ana e Neshat Ademit, ish anëtar i Aleancës për Shqiptarët; - Kryetari i partisë GROM, Stevço Jakimovski drejtoi ofendime dhe thirrje për dhunë ndaj gazetarit të TV24, Gorazd Çomovski; - Kërcënime të drejtpërdrejta për jetën drejtuar nëpërmjet rrjetit social Twitter drejt gazetares Tanja Milevska, korrespondentë e MIA-s nga Brukseli.
<p>Sulme ndaj gazetarëve Llojet e sulmeve reale mbi gazetarët mund të përfshijnë lëndim fizik ose mendor, kidnapim, hyrje në shtëpi ose zyrë, konfiskim të pajisjes, paraburgim arbitrar, tentim i pasuksesshëm për atentat etj.</p>	2	<ul style="list-style-type: none"> - Gazetari është redaktor i portalit Lider, Ljupço Zlatev, është sulmuar në një lokal në Shkup; - Gazetarja Milka Smilevska dhe kameramani Jorde Angeloviq nga Al Xhezeira janë sulmuar nga një person i panjohur gjatë protestës së partisë politike VMRO-DPMNE në qendër të Shkupit.
<p>Vrasje të gazetarëve Vrasje në zjarr të kryqëzuar, atentate, vrasje në eksplozim të bombës, rrahje deri në vdekje etj.</p>	0	
<p>Kërcënime dhe sulme mbi mediet dhe organizatat e gazetarëve</p>	2	<ul style="list-style-type: none"> - Pas shpalljes së storjes hulumtuese lidhur me aktivitetet ndërtimore në lagjen Taftalixhe në Shkup, redaksia e IRL ka qenë pre e sulmeve verbale, presioneve dhe shqetësimeve; - Deri te gazetarët dhe aktivistët e Civil Media, Xhabir Deralla dhe Petrit Saraçini, janë drejtuar kërcënime dhe nënçmime nëpërmjet rrjetit social Facebook, nga një person i quajtur Marjan Kamilovski.

Themelore Publike për vepër penale – rrezikim të sigurisë. Në mars të vitit 2020, Gjykata Themelore Penale në Shkup shqiptoi dënim me burg për kërcënuesin në kohëzgjatje prej gjithsej një viti e 8 muaj. Rasti i tretë është i lidhur me gazetaren Miroslava Burns nga gazeta Sloboden Peçat, e cila gjatë korrikut të vitit 2020 mori një sërë kërcënimesh nëpërmjet profilit të saj personal në Facebook, për shkak të publikimit të një teksti për një dasmë në Tetovë, duke zbardhur grupime që nuk ishte e lejuar gjatë pandemisë me Covid -19. Sulmet e këtilla kanë shkaktuar frikë dhe shqetësim të gazetarja. Rasti është regjistruar nga SHGM-ja dhe është paraqitur në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Rasti i katërt nga kjo kategori janë kërcënimet drejt ekipit të TV Klan. Pas incizimit të bërë të një grupi më të madh të emigrantëve që ka lëvizur në rajonin e Vaksincës, gazetari Furkan Saliu, me ekipin e TV Klanit janë takuar me një automobil nga i cili ka dalë një njeri, i cili u ka drejtuar kërcënime të drejtpërdrejta gazetarëve dhe ka kërkuar nga ata menjëherë t'i fshijnë incizimet. Rasti menjëherë është paraqitur në polici nga ana e gazetarëve, ndërsa Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë kërkoi të identifikohet personi, si dhe të parashtrahet padi adekuate penale deri te Prokuroria Themelore Publike.

Gazetarja Almedina Ismajli ka përgatitur një artikull në të cilin është përmendur Neshat Ademi, ish anëtar i Aleancës për Shqiptarët, pasi në profilin e tij në Facebook ka publikuar informatë se largohet nga partia. Pas publikimit të artikullit, gazetarja ka marrë thirrje telefonike, në të cilën Ademi ka drejtuar kërcënime serioze drejt saj. Rasti është paraqitur në polici, ndërsa kërcënuesi që të nesërmen është thirrur në bisedë informative. Sipas njohurive të SHGM-së, Ademi ka marrë vetëm vërejtje verbale nga ana e organeve ndjekëse. Kryetari i partisë GROM, Stevço Jakimovski ka drejtuar ofendime dhe thirrje për dhunë drejt gazetarit të TV24, Gorazd Çomovski. Jakimovski shkroi status në profilin e tij në Facebook menjëherë pas publikimit të një pjese të intervistës së Çomovskit me liderin e VMRO-DPMNE-së, Hristijan Mickoski. Ai me fjalë fyese e ka ofenduar Çomovskin, madje edhe e „qortoi“ Mickoskin pse „nuk e ka kapur për veshi dhe ta nxjerrë jashtë“. Kërcënime të drejtpërdrejta për jetën janë drejtuar edhe ndaj gazetares Tanja Milevska, korrespondente e Agjencisë Shtetërore MIA nga Brukseli, nëpërmjet rrjetit social Twitter.

Një tjetër sulm fizik ndodhi në një lokal të Shkupit mbi gazetarin dhe redaktorin e portalit Lider, Ljupčo Zlatev. Ai, menjëherë pas incidentit e ka paraqitur rastin në polici, pas së cilës është bërë procesverbal nga ana e nëpunësit policor. Gazetarja Milka Smilevska dhe kameramani Jorde Angeloviq nga Al Xhezeira janë sulmuar dhe penguar në kryerjen e detyrave të tyre profesionale gazetareske nga një person i panjohur në protestën e organizuar nga partia politike VMRO-DPMNE, në qendër të Shkupit. Sipas videove dhe deklaratave të

gazetares në lidhje me incidentin, pasi ka pyetur nga cili medium janë, personi ka pasur kontakt fizik me ta dhe e ka shtyrë mikrofonin e gazetares.

Pas numrit dukshëm më të madh të sulmeve verbale dhe kërcënimeve drejt gazetarëve, në vitin 2020 u regjistruan edhe më shumë paraqitje jo shembullore të funksionarëve qeveritarë,⁵⁹ përfaqësues të Kuvendit,⁶⁰ drejtorëve të agjencive nacionale,⁶¹ institucioneve⁶² por edhe iderëve të partive politike,⁶³ në të cilat ata në njëfarë mënyre ofendojnë ose sulmojnë gazetarë. SHGM më shumë herë ka reaguar për paraqitjet e tilla, duke theksuar se me këtë lëndohet integriteti i gjithë profesionit gazetaresk dhe se funksionarët publikë, e posaçërisht liderët e partive politike, si dhe bartësit e tjerë të funksioneve publike duhet të përmbahen nga deklaratat që mund të kuptohen si etiketim i gazetarëve dhe medieve, sepse me këtë rrënohen vlerat demokratike dhe liria e profesionit gazetaresk.

Në vitin 2020, po ashtu, është vërejtur përvojë negative e etiketimit publik të medieve dhe gazetarëve nga ana e deputetëve në Kuvendin e RMV, për të cilën SHGM disa herë ka reaguar publikisht. Sjellja e tillë e deputetëve, jo vetëm që paraqet presion dhe kërcënim të lirisë së gazetarëve në kryerjen e profesionit të tyre, por është edhe shkelje e Kodit për sjellje etike të deputetëve.

59 SHGM, "Dënojme ofendimet dhe kërcënimet e Stevço Jakimovskit ndaj gazetarit Gorazd Çomovski", Shkup: 2020. Qasur më: 01.09.2020. <https://znm.org.mk/osudaza-navredite-i-zakanite-na-stevch/>

60 SHGM, "Deputetët nuk guxojnë t'i nënçmojnë dhe etiketojnë gazetarët e TV Telma", Shkup: 2020. Qasur më: 28.12.2020. <https://bit.ly/3tOKcSw>

61 SHGM dhe KEMM, "Dënojme kërcënimet dhe diskreditimet ndaj gazetarëve", Shkup: 2020. Qasur më: 29.07.2020. <https://bit.ly/33LZ6hP>

62 SHGM, "Dënojme sjelljen e papërshtatshme të IDKNA ndaj gazetës KOHA", Shkup: 2020. Qasur më: 02.10.2020. <https://bit.ly/3fld7bS>

63 SHGM, "Dënojme nxitjen e urrejtjes të deputetit Apasiev ndaj gazetares Dimkoviq nga portali A1on"; "Dënojme etiketimin publik të Aleancës për Shqiptarët ndaj TV 21"; SHGM: BDI të ndërpresë me etiketimin e gazetarëve"; "SHGM: Dënojme fuqishëm kërcënimet ndaj gazetares së TV 21"; "Dënojme ofendimet dhe kërcënimet e Stevço Jakimovskit ndaj gazetarit Gorazd Çomovski", Shkup: 2020. Qasur më: 20.12.2020. www.znm.org.mk

C2 Sjellja e institucioneve shtetërore dhe e aktorëve politikë ndaj mbrojtjes së gazetarëve

A ekzistojnë dispozita të posaçme ligjore ose mekanizma tjerë që sigurojnë mbrojtje të gazetarëve, offline dhe online?

Kur flitet për mos procesimin e sulmeve mbi gazetarët, konstatohet se niveli i mosndëshkimit është shumë i lartë. Në rrethin që e formojnë Ministria e Punëve të Brendshme, Prokuroria Publike dhe gjykatat, thuajse çdo herë procedura zvarritet nga njëra nga këto tri institucione, por më shpesh ajo është Prokuroria Themelore Publike, pasi që rrallë ndodh ky institucion kompetent të ngre aktakuza ndaj autorëve të dhunës para Gjykatës Penale. Gjatë dy viteve të fundit, për fat të keq, kjo dukuri është më e theksuar pasi Prokuroria Publike në disa raste të sulmeve mbi gazetarët aspak nuk ka ndërmarrë veprime, ndërsa në rastet kur ka ndërmarrë hetime, i ka udhëhequr tepër ngadalë dhe pa efikasitet.

Edhe në vitin 2020, përsëri vërehet trendi i dënimit publik të sulmeve mbi gazetarët dhe punonjësit mediatik, ndërsa për një pjesë të rasteve edhe SHGM ka reaguar publikisht. SHGM e dënoi nxitjen e urrejtjes nga deputeti Dimitar Apasiev ndaj gazetares Gabriela Dimkoviq nga portali Aton. Deputeti Apasiev në faqen e tij në Facebook publikisht e etiketonte dhe nënçmonte gazetaren për shkak të shkrimeve të saja të mëparshme lidhur me ndryshimet e Ligjit për financimin e partive politike.⁶⁴

A ekzistojnë mekanizma për monitorim dhe raportim për kërcënime, maltretime dhe dhunë mbi gazetarët? A publikojnë institucionet shtetërore të dhëna të përditësuara për sulmet mbi gazetarët dhe për mosndëshkimin?

Ministria e Punëve të Brendshme ka Regjistër të brendshëm për sulme mbi gazetarët, por ato të dhëna nuk i publikon edhe pse SHGM i ka paralajmëruar të mbajnë një regjistër të tillë. Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë mban regjistër të sulmeve dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve.⁶⁵ Regjistri përditësohet rregullisht dhe është publik në ueb faqen e SHGM-së.

A ekzistojnë dokumente (protokolle, rregullore etj.) të miratuara nga institucionet shtetërore, që sigurojnë udhëzime për ushtrinë dhe policinë, në të cilat ndalohet maltretimi, frikësimi dhe sulmet fizike ndaj gazetarëve?

Deri më tani ushtria dhe policia nuk kanë miratuar dokumente të brendshme të cilat i udhëzojnë zyrtarët policor si të sillen me gazetarët. Këto institucione nuk kanë as rregullore ose dokumente tjera që ndalojnë kërcënimet, frikësimet ose sulmet mbi gazetarët. Por, në vitin 2020 SHGM-ja, në bashkëpunim me Qendrën Ndërkombëtare për Parandalim dhe Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, filloi një projekt bashkë me Ministrinë e Mbrojtjes dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme. Një nga rezultatet e këtij aktiviteti është krijimi i protokolleve dhe miratimi i tyre nga institucionet dhe mediet në drejtim të informimit etik për çështje lidhur me temat për parandalim dhe luftë kundër ekstremizmit të dhunshëm.

A bashkëpunojnë institucionet shtetërore me organizatat e gazetarëve në lidhje me çështjet e tyre të sigurisë? A përmbahen institucionet shtetërore në aprovimin dhe promovimin e kërcënimeve mbi gazetarët?

Me qëllim të sigurimit të gazetarëve dhe dhënien fund mosndëshkimit të sulmeve mbi gazetarët, SHGM bashkëpunon thuajse me të gjitha institucionet relevante në vend. Këtë vit u mbajt uebinar me temë „Ndryshimi dhe plotësimi i Kodit Penal: Zgjidhje për përforcimin e sigurisë së gazetarëve“. Në uebinar morën pjesë afër tridhjetë pjesëmarrës, mes të cilëve gazetarë, përfaqësues të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Ministrisë së Drejtësisë, nga Këshilli i Evropës, nga Prokuroria Themelore Publike dhe avokatë që përfaqësojnë gazetarë para gjykatave. Në uebinar, video-paraqitje pati edhe Bojan Mariçiq, ministër i Drejtësisë, ndërsa në pjesën hyrëse foli edhe Patrik Peninks, udhëheqës i sektorit për shoqëri informatike pranë Këshillit të Evropës. Konkluzioni kryesor ishte se vetëm nëpërmjet ndryshimeve konkrete të Kodit Penal, duke i dhënë kompetenca Prokurorisë të veprorë sipas detyrës zyrtare dhe nëpërmjet rritjes së dënimeve ndaj sulmuesve, në mënyrë sistematike do të përmirësohet siguria dhe politika e mosndëshkimit ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik.

Në drejtim të intensifikimit të bashkëpunimit, më 30 dhjetor të viti 2019 u nënshkrua edhe Protokoll për bashkëpunim mes SHGM-së dhe Ministrisë së Punëve

⁶⁴ [Safejournalists.net](https://bit.ly/3tZGoE), "SHGM: Dënojmë nxitjen e urrejtjes së deputetit Apasiev ndaj gazetares Dimkoviq nga Aton", Shkup: 2020. Qasur më: 25.12.2020. <https://bit.ly/3tZGoE>

⁶⁵ SHGM, "Rastet e shkeljes së të drejtave të gazetarëve", Shkup: 2019. Qasur më: 17.12.2020. <https://znm.org.mk/izvestai/sлучай-на-повреда-на-право-на-новин-и/>

të Brendshme (MPB).⁶⁶ Protokollin për bashkëpunim mes SHGM-së dhe MPB-së paraqet marrëveshje për bashkëpunim në procesin e zhvillimit dhe promovimit të marrëdhënieve të mira mes punonjësve mediatik dhe nëpunësve të policisë. Nevoja për këtë protokoll është plotësimi i relacioneve tanimë të vendosura mes SHGM-së dhe MPB-së, që janë shënuar në Memorandumin për bashkëpunim të 27 dhjetorit të vitit 2017, si dhe në Doracakun për siguri të gazetarëve gjatë kohës së ngjarjeve me rrezik të lartë, Doracakun për etikën në gazetari, Doracakun për punë profesionale, të sigurt dhe etike të kameramanëve të medie dhe trajnime të shumta dhe aktivitete të përbashkëta të realizuara gjatë dy viteve të kaluara.

Në raste të vëzhgimit elektronik, a e respektojnë institucionet shtetërore lirinë e shprehjes dhe privatësinë? Cili është rasti më i afërt i vëzhgimit elektronik mbi gazetarët?

Përveç aferës së madhe për përgjimet në vitin 2015, kur qindra gazetarë ishin në listën e përgjimeve të policisë sekrete, SHGM-ja nuk ka njohuri se në vitin 2020 ndonjë gazetar ka qenë i ekspozuar në ndjekje elektronike nga qeveritarët. Ngelet e panjohur në cilën fazë është kontesti gjyqësor në lidhje me këtë çështje dhe vallë është proceduar me qëllim që të vërtetohet shkelje e të drejtave të gazetarëve që ishin përgjuar në vitin 2015.

C3 Sjellja e sistemit gjyqësor civil dhe penal ndaj kërcënimeve dhe dhunës mbi gazetarët

A ekzistojnë reparte adekuate në kuadër të gjykatave civile që janë të përkushtuar në hetimin dhe përndjekjen e kërcënimeve dhe veprave të dhunës kundër gazetarëve?

Gjykata Themelore Civile dhe Penale në Shkup, tanimë katër vite me radhë, nuk është në gjendje të japë informata të hollësishme në lidhje me fazën e procedurës për lëndët në të cilat gazetarët janë viktime. Arsyejimi i tyre është se sistemi i ri i procedimit të lëndëve (AKMIS) bazohet në kode e jo në emrat dhe profesionet e palëve. Në vitin 2020, bashkëpunimi i Gjykatës Themelore Civile është ulur në krahasim me vitin e kaluar. Gjykata vetëm informonte se ka gjithsej tridhjetë e tri

lëndë aktive për veprat shpifje dhe fyerje, në të cilat si palë paraqitet gazetar ose medium.

A sigurojnë Prokurori Publik ose Ministria e Punëve të Brendshme resurse adekuate për kryerjen e hetimeve që kanë të bëjnë me kërcënime dhe vepra të dhunës kundër gazetarëve?

Procedura të veçanta për trajtimin e sulmeve mbi gazetarët nëpër institucione nuk ekzistojnë. Në sistemin gjyqësor – prokurorial në Maqedoni nuk ekzistojnë njësi të veçanta që punojnë në hetimet e rasteve të përndjekjes, mbrojtjes dhe kompensimit të gazetarëve, me qëllim që të arrihet siguria e tyre dhe të pengohet politika e mosndëshkimit. Procedura speciale nuk zbatohen as për rastet kur viktime të sulmeve janë gazetarët. Gjyqësia dhe Prokuroria asnjëherë nuk janë ankuar publikisht se lëndët e gazetarëve nuk mund t'i udhëheqin me efikasitet për shkak të mungesës së resurseve njerëzore dhe materiale. Në këtë temë, në pres – konferencën e mbajtur nga ana e SHGM-së, kryetari Mladen Čadikovski e theksoi kërkesën që Ministria e Drejtësisë të bëjë ndryshime në Kodin Penal, me të cilat duhet të zgjerohet kompetenca e Prokurorisë të veprojë sipas detyrës zyrtare me veprat penale lidhur me sulme dhe kërcënime ndaj gazetarëve dhe të rriten dënimet ndaj sulmuesve.⁶⁷ Ai kërkoi edhe Prokuroria Themelore Publike të formojë njësi të veçantë, e cila do t'i ndjekë sulmuesit e gazetarëve.

Tradicionalisht, viti i tretë me radhë, Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë organizon ngjarje për shënimin e 2 nëntorit – Ditës ndërkombëtare për ndalimin e mosndëshkimit të krimeve kundër gazetarëve.⁶⁸ Me këtë rast u mbajt pres -konferencë, në të cilën folën kryetari i shoqatës, Mladen Čadikovski, si dhe anëtarë të Këshillit Drejtues të Shoqatës. Ata me fjalët e tyre dërguan porosi deri te publiku dhe deri te partitë politike se gazetarët profesionalë, nuk guxon, dhe nuk duhet të sulmohen gjatë kryerjes së detyrave të tyre profesionale. Gjithashtu, dërguan kërkesë deri te Prokuroria Themelore Publike, që të gjitha sulmet dhe kërcënimet ndaj gazetarëve dhe punonjësve mediatik urgjentisht të procedohen dhe të formohet njësi e veçantë e cila do t'i ndjekë sulmuesit e gazetarëve.

Më 11 shkurt 2020, Gjykata Penale në Shkup dha vendim për gazetarin Zoran Bozinovski, i akuzuar në çështjen Shpiun. Bozhinovski u gjykua për spiunazh dhe shantazh në një procedurë të veçantë. Gjatë gjithë gjykimit, SHGM i bëri thirrje Prokurorisë Themelore

⁶⁶ SHGM, "Protokoll bashkëpunimi ndërmjet SHGM dhe MPB"; Shkup: 2019. Qasur më: 03.01.2020. <https://znm.org.mk/wp-content/uploads/2020/07/Sorabotka-na-ZNM-i-MVR.pdf>

⁶⁷ SHGM, "Rritje dramatike e sulmeve ndaj gazetarëve – kërkojmë zgjidhje urgjente", Shkup: 2020. Qasur më: 12.11.2020. <https://bit.ly/3fq9nbG/>

⁶⁸ Ibid.

Publike, dhe më vonë PPS, të tërheqë aktakuzën kundër Bozinovskit, për të cilën kishte indikacione serioze se ishte e motivuar politikisht.⁶⁹ SHGM në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare të mediave për këtë rast ofruan ndihmë juridike falas.

A sigurohen masa adekuate për mbrojtje të gazetarëve në raste kur është e nevojshme, si përgjigje ndaj kërcënimeve të mundshme mbi sigurinë e tyre fizike?

Këtë vit nuk kemi vërejtur raste të sigurimit fizik nga MPB për ndonjë gazetar të caktuar. Edhe pse ballafaqohen me frikë, kryesisht, gazetarët nuk dëshirojnë të kenë sigurim fizik sepse ajo mund të ndikojë mbi lirinë e tyre të punës dhe sigurimin e informatave të reja.

A janë në kohë, të pavarura dhe efikase hetimet e veprave penale mbi gazetarët?

Sa i përket punës së institucioneve dhe zbardhjes së sulmeve mbi gazetarët ekziston moskoordinim i caktuar dhe dobësi në komunikimin ndërinstitucional, e kjo më e dukshme është mes MPB-së dhe PTHP-së. Kjo ndikon që lëndët, gjegjësisht hetimet të zgjasin shumë, madje edhe kur bëhet fjalë për lëndë të qarta që mund lehtë të dëshmohen. Rastet ku janë sulmuar gazetarët ende shumë rëndë arrijnë në epilog gjyqësor, dhe rrallë arrihet deri të autorët. Mosndëshkimi i autorëve ngelet i lartë dhe epilogu gjyqësor është konstatuar në më pak se 10 % nga rastet e regjistruara. Për shembull, ish kryetari i SHGM-së, Naser Selmani mori mesazh kërcënues në Facebook. Personi që kërcënohej edhe publikisht pranoi se e ka bërë këtë, ndërsa PTHP dhe MPB edhe pas një viti e gjysmë nuk mund ta zbardhin këtë rast. Kjo qasje neglizhuese e institucioneve sjell deri te situata që sulmuesit të inkurajohen të sulmojnë gazetarë sepse e dinë se drejtësia asnjëherë nuk do t'i arrijë. Prandaj SHGM vlerëson se hetimet janë joefikase, ndërsa masat për mbrojtje joadekuate.

Numri i rasteve tërësisht të zbardhura të sulmeve mbi gazetarët është i vogël dhe nga aspekti i mosndëshkimi i kryerësve kjo brengos. Përfundim gjyqësor marrin mes 5 dhe 10 për qind nga lëndët e regjistruara të shkeljes së të drejtave të gazetarëve, që gjenden në regjistrin për sulme të SHGM-së për pesë vitet e fundit.

Në dhjetor të vitit 2020, Gjykata Themelore Civile në Shkup solli aktgjykime me të cilat refuzohen paditë nga ana e gazetareve Natasha Stojanovska dhe Dushica Mërgja, të cilat kërkonin dëmshpërbim nga shteti për shkelje të të drejtave të tyre gjatë ngjarjeve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut,

⁶⁹ Shpallja e Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë (SHGM), 2 mars 2020, <https://znm.org.mk/sa/shgm-mirepret-lirimin-e-bozinovskit/kor>

më 27.04.2017. Këto padi pasuan pas thirrjes së SHGM-së për sigurimin e ndihmës juridike për gazetarët dhe punonjësit mediatik, të cilët u sulmuar ose të cilëve u është dëmtuar pajisja e tyre në Kuvend gjatë asaj ngjarjeje të pakëndshme. Ky aktgjykim është edhe një dëshmi së ekzistojnë standarde të dyfishta për gjykatën kur janë në pyetje politikanët dhe gazetarët. Në rastin me grupin e politikanëve, Prokuroria Themelore Publike, sipas detyrës zyrtare, ngriti procedura dhe Gjykata Penale dënoi me dënime me burg një grup qytetarësh, ndërsa në rastin e gazetarëve ata ishin lënë të ngrenë padi private. Në arsyetimin gjyqësor theksohet se gazetarët nuk kanë dërguar dëshmi të mjaftueshme që të mund të vërtetohet se më 27.04.2017 kanë ndodhur demonstrata publike para Kuvendit, edhe pse ata kanë dërguar video-incizime me padinë, por ekzistojnë edhe një numër tejet i madh i publikimeve gazetareske nga dita kritike.

Përveç kësaj, në takimet me MPB⁷⁰-në vazhdimisht insistohej për hetime më të shpejta dhe më efikase për sulmet ndaj gazetarët, por edhe për përmirësimin e kushteve për punë të gazetarëve dhe punonjësve mediatik, kur raportojnë nga hapësirat e këtij institucioni. Me sugjerim të SHGM-së, si dhe pas theksimit të asaj mungese në raportet e institucioneve ndërkombëtare, Ministria e Punëve të Brendshme filloi të mbajë evidencë për sulmet mbi gazetarët dhe punonjësit mediatik. SHGM me Avokatin e Popullit në maj të viti 2019 nënshkroi Memorandum për bashkëpunim nëpërmjet të cilit të dy institucionet u angazhuan të punojnë në të ardhmen në temat lidhur me sigurinë e gazetarëve.

Në kontekst të dënimit të dhunës mbi gazetarët dhe thirrjet për zbardhje sa më të shpejtë të atyre sulmeve, Komisioni Evropian, në Raportin vjetor për progresin e RMV-së në vitin 2020, përsëri e trajton çështjen e sigurisë dhe frikësimit të gazetarëve dhe rekomandon: „Nevojitet koordinim më i mirë mes institucioneve të ndryshme për veprim më të shpejtë në lidhje me shkeljet e paraqitura. Politikanët dhe nëpunësit publikë ende duhet të tregojnë nivel më të lartë të tolerancës ndaj kritikave dhe ta promovojnë lirinë e shprehjes“.⁷¹

⁷⁰ SHGM, "Seksioni i kameramanëve pranë SHGM në takim me MPB"; Shkup: 2019. Qasur më: 19.12.2020. <https://znm.org.mk/sekcizjata-na-snimateli-pri-znm-nasred/>

⁷¹ Komisioni Evropian, "Raport i Komisionit Evropian për Maqedoninë e Veriut për vitin 2020", Bruksel: 2020. Qasur më: 15.11.2020. <https://www.sep.gov.mk/post/?id=5657#YAGhuthKjIU>

A siguron shteti trajnim adekuat për policinë, prokurorët, avokatët dhe gjykatësit në lidhje me mbrojtjen e lirisë së shprehjes dhe mbrojtjen e gazetarëve? A i organizojnë këto trajnime në bashkëpunim me shoqatat e gazetarëve?

Akademia për trajnimin e gjykatësve dhe prokurorëve publikë, në bashkëpunim me SHGM-në, do të vazhdojnë të realizojnë trajnime me gazetarët dhe përfaqësuesit e drejtësisë në vitin 2020/21, e përveç kësaj, tema lidhur me lirinë e shprehjes janë pjesë edhe kurikulimit të rregullt për trajnime të Akademisë, dedikuar gjykatësve dhe prokurorëve.

Në kuadër të bashkëpunimit me institucionet, SHGM mbajti takime konsultative me thuajse të gjitha institucionet që duhet ta garantojnë sigurinë e gazetarëve, përfshirë edhe kryetarët e Prokurorisë Themelore Publike, Gjykatës Themelore Penale dhe Gjykatës Themelore Civile, ministrin e Drejtësisë.⁷² Me

qëllim që të zvogëlohet përqindja e mosndëshkimit të sulmeve mbi gazetarët, SHGM bashkëpunonte dhe mbante takime me Prokurorin Publik Shtetëror.⁷³ Në këto takime u hapën më tepër çështje lidhur me përmirësimin e sigurisë së gazetarëve dhe punonjësve mediatik dhe si Prokuroria Themelore Publike të jetë më aktive në përndjekjen e atyre që kërcënojnë gazetarët dhe ua shkelin të drejtat e tyre, si dhe për nevojën e organizimit të trajnimeve të përbashkëta dhe punëtorive për gazetarë, gjykatës dhe prokurorë, me qëllim të përmirësimit të informimit nga gazetarët dhe veprimit të prokurorëve për rastet lidhur me lirinë e fjalës.

72 SHGM, "Jo programit të paguar politik me para publike", Shkup: 2020. Qasur më: 10.10.2020. <https://bit.ly/3eN39Rp>

73 SHGM, "SHGM kërkon nga PTHP departament special për zgjidhjen e sulmeve ndaj gazetarëve", Shkup: 2020. Qasur më: 10.10.2020. <https://bit.ly/3bs0Ot6>

Tabela 3. Pasqyrë e rasteve të kërcënimeve dhe sulmeve mbi gazetarët gjatë 5 viteve të kaluara

Viti	2016	2017	2018	2019	2020
Rasti					
Ekipi i gazetarëve të TV 21					
Pas incizimit të reportazhit televiziv për ankesat e banorëve të komunës së Haraçinës për infrastrukturën e keqe, familjarët e kryetares së komunës Milikije Halimi kanë bërë kërcënim verbal se do t'ua thyejnë kamerat dhe kanë kërkuar të fshihen incizimet.					Rasti nuk është paraqitur në polici, por SHGM disa herë ka bërë thirrje deri te policia dhe Prokuroria Publike të nisin hetime. Sidoqoftë, Prokuroria vendosi të mos veprojë sipas informacionit të dëgjuar.

Viti	2016	2017	2018	2019	2020
Rasti					
Naser Selmani Gazetari dhe atëherë kryetar i SHGM-së ka marrë porosi me kërcënim për jetën nga Bejtulla Asani, vëllai i Bekir Asanit, i cili është i lidhur me partinë politike në pushtet BDI.			Rasti është paraqitur në polici, ndërsa Prokuroria ka nisur hetime. Deri më tani janë ftuar të japin deklaratë edhe Naser Selmani edhe kërcënuesi.	Rasti është në procedurë pranë Prokurorisë Themelore Publike.	
Armand Braho Dhunues nga partia Aleanca për Shqiptarët e kanë sulmuar gazetarin Armand Braho gjatë konferencës, në të cilën ai ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt.			Rasti është paraqitur në polici. Gjykata i ka dënua sulmuesit me gjobë në të holla.		
Një grup gazetarësh Më shumë gazetarë dhe punonjës mediatik u sulmuan nga turma që hyri me dhunë në Kuvend më 27.04.2017.	Rasti është paraqitur në polici. Prokuroria nuk ka ndërmarrë kurrfarë masash.	Prokuroria i ndjek personat që sulmuan politikanë, e nuk i ndjek personat që sulmuan gazetarë dhe punonjës mediatik.		Avokatët e SHGM-së përfaqësojnë 7 gazetarë dhe në emër të tyre do të parashtrojnë 4 padi nga të cilat 3 janë individuale dhe një grupore për 3 gazetarë.	
Vladimir Zhelçeski dhe Aleksandar Todorov Të dy gazetarët, duke raportuar në protestën e madhe „Për Maqedoni të përbashkët“ janë sulmuar fizikisht nga persona të panjohur – pjesëmarrës në protestë, sepse nuk kanë qenë nga medium pro – qeveritar. Janë goditur disa herë, nga e cila kanë marrë lëndime trupore, pas të cilave janë mbajtur në spital 24 orë.	Rasti është paraqitur në polici dhe Prokuroria Publike ka hapur hetime.	Gjykata ka shqiptuar dënim me burg prej 6 muajve për sulmuesit.			
Meri Jordanovska Emil Jakimovski ka kërcënuar dhe ofenduar gazetaren dhe zëvendës redaktoren e portalit A1on, Meri Jordanovska. Sipas porosive që i publikoi Jordanovska, kërcënuesi me fjalë të ndyta e ka ofenduar dhe e ka kërcënuar „se do ta krijojë në nekrolog“.					Propozim aktakuzë për vepër penale rrezikim të sigurisë, për porositë kërcënuese nëpërmjet rrjetit social Telegram. Aktgjykim K. nr. 212/20 nga 16.03.2020, me të cilin është gjykuar me dënim me burg në kohëzgjatje prej 1 viti e 8 muaj. Kundër aktgjykimit është parashtruar ankesë, por ankesa është refuzuar dhe gjykimi është vërtetuar nga gjykata e shkallës së dytë.

Konkluzione dhe rekomandime

Në vitin 2020, Ministria e Drejtësisë formoi grup pune për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për përgjegjësi civile për ofendim dhe shpifje, në të cilin marrin pjesë edhe përfaqësuesit e SHGM-së. U pranuan pothuajse të gjitha vërejtjet e SHGM-së në drejtim të zvogëlimit të shkallës së dëmit jo – material gjatë vërtetimit të fajit ndaj gazetarit, si dhe për precizimin e dispozitave për mënjanimin e përgjegjësisë për shpifje dhe ofendim. Ministri i Drejtësisë paralajmëroi se ligji do të miratohet në dhjetor të vitit 2020, por procesi përsëri u prolongua për në vitin 2021.

Reforma e servisit publik radiodifuziv publik thuajse ende nuk ka nisur, ndërsa pavarësia dhe qëndrueshmëria financiare e servisit publik radiodifuziv publik ngelet çështje e hapur. Posaçërisht është e rëndësishme të gjinden zgjidhje për borxhet e vjetra të servisit publik radiodifuziv ndaj institucioneve shtetërore.

Çështja që brengos nga aspekti i mbrojtjes së pluralizmit politik është reklamimi i paguar politik, i cili nuk është i ndaluar në mënyrë eksplicite në periudhë jashtë zgjedhjeve, ndërsa gjatë fushatës zgjedhore mbulohet me mjete të Buxhetit. Qëndrimi i SHMG-së është se reklamimi i paguar politik në media duhet të ndërpritet në cilëndo periudhë sepse në këtë mënyrë „blihen“ pronarët e medieve, dhe kjo praktikë ka ndikim negativ mbi politikën redaktuese të medieve, ndërsa plotësisht „zhvendoset“ edhe baraspesha e pikëpamjeve kundërthënëse në sferën publike. SHGM-ja kundërshton edhe ndryshimet eventuale në Ligjin për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, me të cilat do të lejohej reklamimi i institucioneve publike në mediet audiovizuale. Kjo do ta sillte gjendjen në industrinë e medieve në nivelin e para pesë viteve, kur me mjete shtetërore, në mënyrë jo – transparente mediave iu paguan shuma astronomike pa asnjë kriter. Nëse propozimi i këtillë pranohet, nuk do të sjellë kurrfarë përmirësimi të gjendjes në media, por përkundrazi, plotësisht do

ta çrregullojë tregun edhe ashtu të brishtë mediatik dhe do ta përforcojë klientelizmin.

Vlerësim i përgjithshëm është se në vitin 2020 pozita socio-ekonomike e gazetarëve ishte plotësisht e vështirësuar për shkak të pandemisë, gjegjësisht për shkak të zvogëlimit të të ardhurave nga reklamimet në gjithë sektorin mediatik. Statusi i punës së shumë gazetarëve, posaçërisht në media private është i pasigurt, sepse gazetarët kryesisht kanë kontrata me afat të caktuar ose kontrata për honorar, nuk u paguhet kontributi për sigurim pensional dhe social, të ardhurat i kanë të vogla, ndërsa nuk u respektohen edhe të drejtat e tjera të punës. Prandaj, gazetarët janë shumë më të ndjeshëm ndaj presioneve, sikurse nga strukturat menaxheriale ashtu edhe nga pronarët dhe politikanët. Presionet më shpesh janë subtile dhe pak të dukshme, gazetarët përmbahen nga të folurit hapur për këto dukuri dhe rrallë paraqesin kur u cenohen të drejtat themelore. Edhe pse vlerësohet se gazetarët në redaksi kryesisht kanë liri më të madhe, ka shumë ndikime mbi punën e përditshme të cilat nuk janë ashtu të dukshme, gjegjësisht ka më shumë vetë – censurë sesa presione të drejtpërdrejta. Më e vështirë është pozita e gazetarëve të medie lokale dhe rajonale, sepse këto media janë në gjendje të rëndë financiare, e përveç kësaj në mjedise të vogla, të fuqishmit lokalë mundën më lehtë të bëjnë presion. Statusi i punës dhe pozita e gazetarëve në redaksi nuk dallohet nga ajo e kolegëve të tyre gazetarë meshkuj, me përjashtim të faktit se në pozitat udhëheqëse të medie ka më pak gra.

Në vitin 2020, numri i sulmeve mbi gazetarët ishte rritur në mënyrë drastike, gjegjësisht ishin regjistruar tri herë më shumë sulme mbi gazetarët në krahasim me vitin 2019. Veçanërisht brengos fakti që gazetarët dhe punonjësit mediatik shumë shpesh janë cak i kërcënimeve dhe keqtrajtimit në rrjetet sociale, nga të cilat një pjesë ishin kërcënime serioze për sigurinë fizike të gazetarëve të cilët punojnë në hulumtimin e korrupsionit dhe dukurive tjera negative shoqërore. Gjithashtu kishte edhe shembuj të gjuhës së urrejtjes dhe etiketimit të gazetarëve dhe punonjësve mediatik nga ana e politikanëve dhe bartësve tjerë të funksioneve publike. Mosndëshkimi ende është problem i madh, sepse institucionet kompetente nuk bashkëpunojnë sa duhet dhe rrallë ngrenë aktakuzë ndaj autorëve të kërcënimeve dhe sulmeve. Ndërsa në rastet kur janë ngritur hetime, ato janë zhvilluar shumë ngadalë dhe pa efikasitet. Përveç kësaj institucionet kompetente dhe gjykatat ende nuk mbajnë evidencë të përditësuar për kërcënimet dhe sulmet mbi gazetarët, e as i publikojnë të dhënat e tilla. Sidoqoftë, është pozitive që institucionet kompetente janë të hapur për bashkëpunim me SHGM-në dhe me konsultime të përbashkëta tregojnë gatishmëri të punohet në përmirësimin e sigurisë së gazetarëve dhe punonjësve mediatik nëpërmjet

ndërmarrjes më efikase të masave dhe ndjekjes së kryerësve të sulmeve dhe kërcënimeve.

REKOMANDIME

Ndërhyrje ligjore dhe përmirësimi i zbatimit të ligjeve:

- Zbatimi i procedurës për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të ASHMAA dhe Këshillit Programor të RTM nga Kuvendi i RMV-së. Procedura duhet të zhvillohet në një mënyrë transparente, me një shqyrtim publik të të gjithë kandidatëve, duke ruajtur parimin e shumicës së dy të tretave në vendimmarrjen e Kuvendit.
- Është e nevojshme të analizohen dispozitat e Ligjit për Shërbimet Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe ligjeve të tjera përkatëse në drejtim të përmirësimit të situatës financiare të medie private dhe vendosjes së mekanizmave për lehtësim tatimor dhe përfitimeve të ngjashme për mediet.
- Është e nevojshme të hapet debat mbi krijimin e një fondi të mundshëm për media, veçanërisht mbi qëllimet dhe kriteret e mbështetjes financiare (inkurajimi i llojllojshmërisë programore, përmirësimi i statusit të gazetarëve etj.), mënyra e shpërndarjes së fondeve, pavarësia dhe objektiviteti në zbatimin e procedurës.
- Nevojiten ndryshime në Kodin Zgjedhor me të cilat do të thjeshtësohen rregullat për fushatën mediatike dhe do të zvogëlohet mundësia e keqpërdorimit të reklamimit të paguar politik në mediet private.
- Duhet të iniciohet ndryshim dhe plotësim i Kodit të Etikës së Gazetarëve në Servisin Publik për të forcuar vetë-rregullimin e brendshëm në këtë medium.

Përmirësimi i sigurisë së gazetarëve:

- Ndryshim dhe plotësim i Kodit Penal në dy drejtime: 1) Ndryshim dhe plotësim i dispozitave me të cilat përcaktohet gjuha e urrejtjes në përputhje me praktikën e GJEDNJ, dhe 2) Ndryshim dhe plotësim në kompetencat e PTHP për të vepruar sipas detyrës zyrtare në rast të një sulmi ndaj një gazetari dhe/ose punonjësi mediatik, si dhe parashikimi i dënimeve më të larta për shkelësit e ligjit. Procedura është paralajmëruar, por është e nevojshme që Ministria e Drejtësisë të shpejtojë procesin.
- Themelimi i një departamenti të ri në kuadër të PTHP, i cili do të jetë i ngarkuar vetëm për trajtimin e çështjeve në lidhje me shkeljen e të drejtave të gazetarëve dhe punonjësve mediatik, sigurinë e tyre, si dhe gjuhën e urrejtjes ndaj tyre.
- Krijimi i regjistrave të veçantë për çështjet e padive kundër gazetarëve, në kuadër të gjykatave themelore civile dhe penale, përfshirë edhe PTHP.
- Vazhdimi i trajnimeve për gazetarë, avokatë, gjyqtarë dhe prokurorë për tema që lidhen me sanksionimin

e sulmeve ndaj gazetarëve dhe interpretimin e përgjithshëm të nenit 10 të GJEDNJ.

- Përmirësimi i bashkëpunimit me përfaqësuesit e sazozgjedhur të Kuvendit të RMV-së për tema në lidhje me lirinë e shprehjes dhe politikat mediatike.
- Vazhdimi i lobimit të SHGM për vendosjen e protokolleve dhe avancimin e procedurave të brendshme në institucione, me qëllim të parandalimit të dhunës ndaj gazetarëve dhe sanksionimin efektiv të saj.
- Përmirësimi i bashkëpunimit me Avokatin e Popullit, në drejtim të rritjes së angazhimit të këtij institucioni në mbrojtjen e të drejtave të gazetarëve.

Përmirësimi i të drejtave të punës të gazetarëve:

- Vazhdimi i përpjekjeve të SPGPM, me mbështetjen e SHGM, në nënshkrimin e marrëveshjeve të reja kolektive me media private.
- Zbatimi i fushatave dhe trajnimeve, përmes të cilave gazetarët dhe mediet do të njoftoheshin më shumë për të drejtat e tyre themelore të punës.
- Sigurimi i ndihmës juridike dhe shërbimeve këshilluese për gazetarët dhe punonjësit mediatik nga shoqatat esnafe të gazetarëve.

